



BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-X

Sh 29

INAJET
SHEHU

DY
NET

PA GJUME




81H-7

Sh 29

INAJET SHEHU

DY NET PA GJUME...

Tregime humoristike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ME QELESHE, FESTE DHE KASKETË...

Atë ditë, Harun beu po kalonte mes për mes pazarit me mendje të ngritur. Po afronte dita e votimeve dhe ai, një ndër kandidatët kryesorë, ende nuk ishte i sigurt nëse do të zgjidhej në parlament apo jo. Ç'është e vërteta, Harun beu, gjatë këtyre ditëve të fundit, nuk kishte ndenjur duarkryq. Në nja dy fjalimet që kishte mbajtur para zgjedhësve kishte premtuar se, po të zgjidhej deputet, do të ngrinte zërin në parlament për shumë probleme që e shqetësonin popullin e veçanërisht për ngritjen e një xhamie të re, akoma më të bukur se pesë ekzistueset. Veç fjalimeve të tij historike, Harun beu e kishte zgjidhur edhe grykën e qeses si kurrëndonjëherë. Ai e shikonte se deri në ditën e zgjedhjeve do të harxhonte shumë napolona, po prapë nuk i vinte keq. Vërtet po harxhonte me trastë tani, po do të fitonte me thes kur të zgjidhej, ama! Po a do të zgjidhej, vallë? Nuk ishte puna vetëm te fjalimet e napolonat. Ishte puna edhe te marifetet. Aq më tepër se edhe kundërshtarët nuk rrinin duarkryq. Kishte marrë vesh se Maliq efendiu dhe Asllan beu kishin dalë, me qeset plot e me një tufë xhandarësh pas, për të blerë sa më shumë vota nëpër fshatrat rreth e rrotull.

Me këto mendime në kokë, duke ecur kuturu e pa veten para dyqanit të tregtar Janit. Qëndroi para vitri-

nës së vjetëruar dhe filloi të vështrojë si i shastisur. Aty ishte një ekspozitë e vërtetë mallrash, mbështjellur të gjitha nga një rrjetë e hollë merimange. E ç'nuk kishte në atë vitrinë: brenevekë, opinga, thumba e patkonj kuaajsh, sheqer, kripë!... Në gjithë këto mallra, vëmendjen e Harun beut e tërhoqën një qeleshe, një feste e një kasketë, të cilat ishin lidhur të tria së bashku me një fije spango, në qoshe të vitrinës. Harun beu shqeu sytë, thua se ndodhej para një ekspozite me punime të rralla artistike. Fytyra e tij e ngrysur u çel e më në fund tha me vete:

— E gjeta!

— Mos të ka humbur gjësendi, Harun bej? — e pyeti tregtar Jani, i cili po qëndronte para dyqanit.

— M'i nxirr shpejt qeleshen, festen e kasketën që ke këtu në vitrinë! — i tha me nxitim Harun beu, sikur të kishte frikë se mos ato do të fluturonin që andej.

Tregtar Jani, sa i habitur aq dhe i gëzuar që iu gjet një blerës, hyri me nxitim në dyqan, i hoqi nga vitrina, u fshiu pluhurin e merimangat dhe ia dorëzoi.

— Ç'të duhen këto, Harun bej? — e pyeti ndërsa tjetri po nxirrte portofolin. — Zotrote mban gjithmonë borsalinë.

— Këto, që thua ti — ia ktheu rëndë-rëndë Harun beu — do të nxjerrin në selamet jo vetëm ty e mua, por një komb të tërë!

«Me sa duket Harun beu paska luajtur nga vidat sot!» — tha me vete tregtar Jani, pastaj dhe u ul sërish në stolin para dyqanit, në pritje të ndonjë blerësi tjetër, të cilët sa vinin e rralloheshin.

Po atë pasdite në konakun e Harun beut u paraqitën tre veta: Hajdari, Alushi dhe Kasemi, që të tre qahallarë të papunë.

— A e merrni me mend përse çova e ju thirra, efendëm? — hyri drejt e në temë Harun beu, buzëgaz.

— Mos na ke gjetur ndonjë punë, Harun bej? — pyeti Alushi, të cilit i ndritën sytë nga një farë shprese.

— Mendjen gjithë tek puna e keni, jahu! Kaq shpejt e harruat fushatën e zgjedhjeve, efendëm? — vazhdoi Harun beu.

Ata të tre vështruan njëri-tjetrin me habi, mblodhën supet dhe ia ngulën sytë Harun beut.

Ai, pa thënë asnjë fjalë, u ngrit nga vendi, hapi një sënduk aty pranë dhe nxori që andej qeleshen, festen dhe kasketën. Qeleshen ia vuri në kokë Hajdarit, festen Alushit, kasketën Kasemit. Pastaj mori edhe borsalinon e tij, e vuri mbi sënduk dhe tha:

— Zotëria ime i ka dhënë karar që secili prej jush të votojë tre herë për mua. Për këtë do të bëjmë një provë qysh tashti. Kjo këtu, ta zëmë, është kutia e votimit — vazhdoi Harun beu duke treguar borsalinon mbi sënduk. — Ju do të qëndroni pas dere dhe, kur t'ju thërras emrat unë, do të hyni brenda të hidhni votat. Sapo të dilni përsëri jashtë, do t'i ndërroni këto që keni në kaptinë dhe do të hyni të votoni përsëri. Puna është që, kur të hyjë herën e parë Hajdari, ta zëmë, të ketë në kokë qeleshen, herën e dytë festen, kurse të tretën herë, kasketën. Morët vesh? Pa të bëjmë një provë, efendëm!

Ata të tre dolën. Kur i fundit mbylli derën, Harun beu thirri:

— Hajdar Qeleshja!

— Hajdari u fut brenda, zgjati grushtin drejt borsalinon dhe thirri sa u tund konaku:

— Ta dhashë votën, zotni deputet!

— Alush Festja, kujt do t'ia japësh votën ti? —
thirri për së dyti Harun beu.

— Zotnisë sate, efendi! — zgjati kokën që pas dere
Alushi dhe vrapoi drejt borsalinos.

— Kasem Kasketa!

Kasemi hyri brenda rëndë-rëndë dhe tërë solemni-
tet futi grushtin komplet në borsalino.

Harun beu, i kënaqur sa s'bëhet nga shkathtësia e
tyre, doli jashtë bashkë me ta, i udhëzoi si duhej të ve-
pronin e pastaj hyri brenda dhe thirri:

— Hajdar Festja!

— Këtu! — ia bëri Hajdari, këtë herë me feste në
kokë.

— Voto për Harun beun!

Hajdari hodhi «votën» dhe doli jashtë.

— Alush Kasketa, për kë e hedh votën në kuti?

— Për zotninë tënde, efendi! — i ndenji hazerxhevap
Alushi dhe ndoqi Hajdarin.

— Kasem Qeleshja!

Edhe Kasemi veproi si dy të parët.

Harun beu sa s'po kërcente prej gëzimit. Mbetej të
provonte edhe variantin e tretë dhe të fundit. I porositi
të kishin kujdes e pastaj i mëshoi zërit:

— Hajdar Kasketa!

— Alush Qeleshja!

— Kasem Festja!

Të tre hynë me rrëmbim në dhomë dhe sa nuk e
shqyen borsalinson, për të futur «votën» kush e kush
më parë.

— Vallahi, bilahi keni qenë të shpejtë si rrufeja! —
përplasi duart i kënaqur Harun beu. — Ku e mësuat kaq
shpejt marifetin, jahu?!



— Na e mësoi Maliq efendiu, Harun bej — tha Alushi.

— Si? Maliq efendiu?! — shqeu sytë Harun beu dhe i ngriu buzëqeshja në fytyrë. — Pse edhe ai... këtë marifet...

— Dje, gjithë ditën kemi bërë prova në konakun e tij me qeleshe, feste e kasketë. Bile na dha edhe nga një napolon si kapar. Po zotrote...

Harun beu zgurdulloi njëherë sytë e pastaj u shemb mbi minder.

«CEREMONIA E HAPJES...»

Shërbimin për në qytetin N. e prita me kënaqësi. Jo vetëm se atje kisha kaluar disa vite të rinisë sime dhe se kisha vite pa vajtur, por edhe për vetë faktin se në atë qytet banonte miku im i vjetër dhe i mirë Qenan Bushi. Me Qenanin ka vite që njihemi familjarisht. Bile njiheshin edhe prindërit tanë, të cilët kanë qenë miq të ngushtë.

Për çudi, njeriu i parë që takova sapo zbrita nga autobuzi ishte pikërisht Qenan Bushi.

— Ke parë ti? — më gëzohej Qenani. — Sikur ma thoshte zemra se do të më vinte një i njohur, po se cili s'e përcaktoja dot. Po ç'na paske dalë?

— Po ja, se mos shkruaj ndonjë gjë për zakonet prapanike e mbeturinat fetare — i thashë.

— Ore, po ç'kujtoni ju andej, se ne këndeje kemi mbetur atje ku na mban mend ti? Jo, vëlla, jo! Kohë të reja, zakone të reja!

Pastaj më futi krahun dhe më drejtoi nga shtëpia e tij. Unë kundërshtova me sa munda, por s'e njihni Qenan Bushin ju. Po nguli këmbë ai për një gjë, s'ka burrë që nuk dorëzohet. Edhe unë, pas një farë qëndrese, kapitullova. Kështu, atë natë shkova mik në familjen Bushi.

Kishte vite që s'kisha qenë në shtëpinë e tij dhe më bëri përshtypje si mobilimi i apartamentit ashtu edhe mënyra e jetesës. Hëngrëm gjithë të mirat në tavolinë,



pimë ujë frigoriferi, pamë një film në televizor ... Si e ëma, nënë Fatimeja, ashtu edhe e shoqja, Liria, u bënë copë që unë të mbetsha sa më i kënaqur prej tyre.

Nënë Fatimesë, megjithëse e shkuar nga mosha, goja i punonte si kanarinës. Ajo fliste e fliste e s'kish të sosur. I gëzohej jetës së re e të bukur, më gëzohej mua. Mirëpo pas buke, ajo u tërhoq në një qoshe të dhomës dhe s'e hapi më gojën. Vetëm lëvizte buzët e mërmëriste diçka që unë s'isha në gjendje ta kuptoja. I hodha një vështrim pyetës Qenanit. Ai bëri një lëvizje me dorë, që pak a shumë donte të thoshte: Ç'ia vë re nënës? Është e vjetër dhe i ikën mendja nganjëherë!» Vija re gjithashtu se Liria nuk ishte e qetë dhe se herë-herë vështron-te nga e vjehrra. «I vjen keq për të» mendova.

Ramë vonë për të fjetur. «Hajde, Qenan, hajde — mendoja shtrirë në krevat — paske krijuar një komoditet për ta pasur zili, o qerrata! «Mendoja kështu dhe më vinte mirë. Më kujtohej familja e tij kur hanin këmbëkryq në sofrën e në një sahan, më kujtohej edhe... Përdërisa në familjen Bushi kishin ndodhur kaq e kaq ndryshime, ishte zor se mund të shkruaja diçka negative, fejtton, siç pata vendosur unë. E ndava mendjen që të bëja një shkrim për këtë familje, ku i ishte dhënë shkëlmi së vjetrës e ku kishte lindur e reja, përparimtarja... Me këtë mendim të bukur në kokë, më mbërtheu gjumi...

* * *

...Kishte kaluar mesi i natës, kur nëpër gjumë m'u bë se dëgjova zhurmë. Hapa sytë dhe pastaj veshët. Qetësi. Mendova se më kishin bërë veshët. Bëra të kthehesha në krahun tjetër, kur dëgjova këto fjalë të pëshpëritura nga një zë i ulët burri:

— Merre atë tepsinë e madhe. . .

Pas këtyre fjalëve dëgjova rrokullisjen e një sendi metalik, një të sharë nëpër dhëmbë e pastaj qetësi. U ngrita ndenjtur në krevat me zemër të ngrirë. Mos vallë në apartamentin e mikut tim kishte hyrë ndonjë keq-bërës dhe më binte barra mua që ta zija me presh në duar? Në të tilla çaste njeriut i vëte mendja gjithkund. — Me hapa të matur dola nga dhoma ku po flija dhe sakaq u ndodha në sallon. Duke mos gjetur send tjetër për vetëmbrojtje, rrëmbeva një fshesë, që fatmirësisht u ndodh në qoshe. Dera e dhomës nga erdhi zëri misterioz ishte gjysmë e hapur. Dhoma ishte kredhur në gjysmë-errësirë, gjë që i jepte një pamje pak a shumë fantastike. Bëra edhe një hap, zgjata kokën dhe shtrëngova fort bishtin e fshesës, kur. . . para syve të mi u shfaq një skenë tipike orientale. Në mes të dhomës, rreth një tepsie të madhe, ishin ulur këmbëkryq, miku im i vjetër Qenan Bushi dhe nënë Fatimeja. Mbi tepsinë dallova një pjatë të mbushur me petulla, një tas me kos dhe ca ushqime të tjera. Pak më tej, në këmbë, qëndronte Liria e përgjurmur.

— Eja tani, mos na vono! — i tha Qenani së shoqes.

— Jo, Qenan. . . nuk është mirë, nuk bën. Ti e kupton vetë — ia ktheu ajo.

— As për hir të nënës — tha ashpër Qenani.

— Nënë e dua dhe e respektoj, por. . .

— Të mjerat ne, ç'ditë arritëm! — tha si vajtueshëm nënë Fatimeja.

— Ditë më të mira as që i ke endërruar, nënë — ia ktheu e reja.

— Po vetëm sonte, moj, vetëm sonte, si nata e parë! — tha Qenani, këtë herë edhe me të lutur edhe me të egër. — Se mos do ta kesh të shkruar në ballë ti që do të mbash një ditë ramazan!

Kur dëgjova këtë fjalën e fundit, sa s'më shpëtoi fshesa nga dora. Kuptova gjithshka. Nesër gdhihej dita e parë e ramazanit dhe Qenan Bushi po bënte «ceremoninë e hapjes» familjarisht, në syfyrin e parë. Vetëm atëherë e kuptova se ç'ishin ato lëvizje të buzëve të nënë Fatimesë pas buke.

— Unë po shkoj të fle — dëgjova zërin e Lirisë. — Natën e mirë!

U tërhoq lehtë e me shpejtësi. Nga hutimi, në krevat hyra me gjithë fshesë. Nga dhoma matanë vinte zhurma e lugëve, që trokisnin në tasin me kos, të cilat më vinin në vesh si gjësimet e daulleve të dikurshme të ramazanit.

* * *

Kur u zgjova nga gjumi në mëngjes, Qenani dhe Liria shkuan në punë. Nga dhoma matanë më përshëndetën të gërhiturat e nënë Fatimesë, që po flinte ende. U hodha dy grushta ujë syve dhe dola. U drejtova për në zyrën e Qenanit. Atë e gjeta pas skrivanisë së punës me kokën të mbështetur mbi duar.

— Mirëmëngjes, Qano! — e përshëndeta.

Si përgjigje mora një gërhitje të gjatë. I fola edhe një herë me zë më të lartë dhe ai brofi i trembur, fërkoj dy-tri herë sytë dhe, si më njohu, u qetësua.

— Erdhe?

— Si duket s'paske bërë gjumë të rehatshëm mbrëmë — i thashë.

— Punë, shumë punë — ma ktheu — Ti re të flesh mbrëmë, kurse unë punova gjer pas mesnate mbi një relacion.

— Kurse mua se ç'm'u shpifën ca ëndrra të liga — i

thashë. — Në njërën prej tyre m'u shfaqe ti dhe nënë Fatimeja, të ulur në mes të dhomës këmbëkryq, duke ngrënë syfyryn e parë të këtij ramazani, ndërsa Liria kundërshtonte.

Unë thosha këto fjalë, ndërsa ai më vështronte si i hutuar. Pastaj kuptoi gjithshka, e mblodhi veten dhe tha:

— Ç't'i bësh? S'mund t'ia prishja nënës... Duhet të kemi respekt për prindërit...

«KURSIMET»

E

KASEMIT

Kasemi po punonte kur dikush e lajmëroi për një mbledhje që do të organizohej menjëherë për problemin e kursimeve.

«Ç'është kjo mbledhje kështu tak-fak? — mendoi Kasemi. — A mund të shkojë njeriu i papregatitur në mbledhje?»

Dhe vendosi të mos futej në mbledhje pa pregatitur një material për diskutim. Veçanërisht për një problem aq të rëndësishëm, siç ishin kursimet.

Ndërsa të gjithë punonjësit filluan të futen në sallë, Kasemi nxori ca fije letre nga sirtari dhe i vuri përpara.

«Pasi të përgatitem me shkrim — mendoi — do të futem brenda e do t'i lë gojëhapur të gjithë me propozimet e mia!»

I joshur nga ky mendim, ndjeu se nga koka mendimet filluan t'i vërshojnë si një lumë i rrëmbyer. Për t'u vënë pritë atyre, mori penën. (Kasemi nuk përdorte kurrë stilograf) u përkul mbi letrat që kishte përpara dhe filloi të shkruajë:

«Duke e kuptuar drejt rëndësinë e kursimeve, i paraqes drejtorisë dhe kolektivit drejtimet kryesore dhe reale se si dhe ku do të kursej unë personalisht.»

Si vuri këtë pikë, Kasemi nxori paqetën, ndezi me të shpejtë një cigare dhe, duke mos humbur asnjë minutë kohë, vazhdoi:

1. NË DREJTIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE:

a. Do të heq urgjentisht dy llampat 60 vatshe që kam në zyrë dhe në vend të tyre do të vendos një llampë 120 vatshe. Me këtë iniciativë i kursej shtetit një llampë elektrike.

b. Me përjashtim të ditëve kur kemi orar zyrtar pasdite, ditët e tjera nuk do të punoj kurrsesi jashtë orarit të punës, duke mos u bërë shkas kështu për konsumim të tepërt të energjisë elektrike.

2. NË DREJTIM TË PAJISJEVE TË ZYRËS:


a) Dritaret e zyrës sime kanë perde të rënda stofi të kushtueshëm. Me qëllim që t'u zgjatet jeta këtyre, mendoj të bëhen edhe një palë perde të holla tyli. Kështu, perdet e trasha do t'i përdor vetëm për dimër, kurse të tyllit për behar. Në këtë mënyrë perdet do të përdoren më pak dhe do t'u zgjatet jeta.

b) Heq dorë vullnetarisht nga kërkesa që kam bërë për një skrivani të re pune. Si i kalitur që jam me vësh-tirësitë, edhe me këtë rast do të bëj si do të bëj dhe do të vazhdoj të punoj me skrivaninë e vjetër, megjithëse ajo po hyn në vitin e dytë të ekzistencës së saj.

c) Gjatë këtyre ditëve. . .

Papritur e lëshoi penën nga dora. Ndieu një dhëmbje therëse në gishtërinjtë e dorës së majtë. Cigarja, të cilën e kishte lënë në harresë ndërmjet gishtërinjve, kishte vajtur gjer në fund dhe e kishte përcëlluar. E lëshoi cigaren i trembur. Ajo ra mbi letrën e shkruar e sakaq, në qendër të saj u hap një vrimë e zezë.

Kasemi pështyu dhe e hodhi tutje. I nevrikosur sa s'bëhet, i mblodhi shuk letrat dhe i përplasi me forcë në



koshin që mbante pranë këmbëve. Pastaj hapi sirtarin dhe nxori letra të tjera. Kur bëri të shkruante, u kujtua se ato që hodhi në kosh duheshin kopjuar. I nxori edhe një herë nga koshi, i kopjoi dhe vazhdoi:

c) Gjatë këtyre ditëve bëra një zbulim modest: konstatova se gjatë ditës së punës harxhoj shumë bojë shkrimi. Kjo, në vështrimin e parë, mund të duket një gjë e vogël dhe e parëndësishme, por në këtë rast unë kam parasysh atë fjalën e urtë popullore, që thotë: «Nga të voglat lindin të mëdhatë», ose atë tjetrën më kuptimplotë: «Gur-gur bëhet kalaja!» Natyrisht, kalaja nuk ngrihet me bojë shkrimi, po fjala vjen.


Konkretisht: me qëllim që t'i pritet një herë e mirë udha bojës së shkrimit për në zyrën time, të më jepet urgjentisht një makinë shkrimi si dhe një makinë llogaritëse me korrent.

3. NË DREJTIM TË KURSIMIT TË KOHËS SË PUNËS:

Nuk do të lëviz absolutisht nga zyra gjatë gjithë tetorëshit. Do të evitoj lëvizjet kohë pa kohë, qoftë edhe nga zyra në zyrë. Për t'i vënë në jetë këto del i nevojshëm vetëm instalimi i menjëhershëm i një aparati telefonik në zyrën time.

Këto, shokë dhe shoqe, ishin vetëm një pjesë e kursimeve që mendoj të bëj operativisht. Për sa citova më sipër, nuk do të kursej djersën, time, mundin tim, entuziazmin tim.»

Si qëndisi fjalët e fundit, Kasemi psherëtiu i kënaqur dhe u mbështet në shpinoren e karrikes. I hodhi një sy dhe e lexoi gjer në fund. Si u bind se gjithshka ishte në rregull dhe se nuk kishte asnjë gabim ortografik, nxori ca fije të tjera letre dhe e hodhi në të pastër. Si mbaroi edhe këtë punë, letrat e para i mblodhi shuk dhe, me një gjuajtje të përpiktë, i flaku në koshin e letrave. U ngrit dhe hapi derën e zyrës që të futej në mbledhje. Kur e



mbylli, u hap dera e këndit të kuq dhe që andej vërshuan njerëzit.

«Sa keq! Mbledhja mbaroi», tha i pikëlluar dhe u hodhi një vështrim keqardhjeje letrave që mbante në duar. Ai nuk do të kishte mundësi të parashtronte para kolektivit propozimet e tij...

— Hë, Kasem, po ti përse nuk erdhe në mbledhje? — dëgjoi t'i thotë Vangjeli, kryetari i komitetit profesional të ndërmarrjes. Nuk e dije se u mblodhëm për një problem me rëndësi?

— Pikërisht se ishte problem i rëndësishëm, shoku Vangjel, edhe unë... — ia ktheu Kasemi dhe iu afrua buzëgaz e i zgjati letrat që mbante në dorë.

Vangjeli i mori dhe filloi t'i lexojë. Fytyrën e tij e mbuloi një nënqeshje ironike. Kasemit sa s'po i çahej krahërori nga emocionet.

— Hë, si ju duken, shoku Vangjel?

— Interesante janë, interesante...

Kasemit sa nuk i ra të fikët nga kënaqësia.

— Bile shumë interesante! — theksoi Vangjeli, — S'kanë nevojë për asnjë redaktim. Mund t'i vëmë në jetë në... grupin e estradës!

KU JANË BRIGADIERËT?

Shëndet e të mira paç, o Hysen! Në përgjigje të ankesave të tua të pafund, prite më së fundi edhe letrën time. Të prita e të prita se mos vije këndeje nga ne, por ti s'u bëre që s'u bëre i gjallë. Si pashë se ti as që po e vije atë ujë në zjarr, mbatha çizmet dhe u nisa të bëj muajin e punës prodhuese në kooperativën bujqësore të Pinjalit. E mban mend Pinjalin? Është kooperativa ku para tre vjetësh kryem bashkë muajin e punës prodhuese e ku ti mbete gojëhapur për rezultatet e tyre në ngritjen e gruas në përgjegjësi. Më kujtohen si sot ato brigadieret e Pinjalit. Të reja, gjithë shëndet dhe entuziazëm në punë. Sidomos njëra prej tyre (ajo që quhej Merushe, të kujtohet?) më bie ndër mend sa herë që këndohet ajo kënga që thotë:

*O moj Merushe, moj bojë esmere,
ty të zgjodhën, moj, brigadiere...*

Pra, që ta kam llafin, pas tre vjetësh, u nisa edhe një herë për në Pinjal, që të kryeja muajin e punës prodhuese. Sapo arrita atje, u drejtova nga zyrat e kryesisë dhe trokita në derën e kryetarit.

— Oho, mirë se na erdhe, bukë e vjetër! — u ngrit nga vendi kryetari dhe u turr e më shtrëngoi fort në qafë.



Ndërruam nga një cigare dhe i tregova kryetarit arsyen e vajtjes sime. Pastaj shpreha dëshirën që të veja e të punoja në brigadën që drejtonte Merushja. Isha i bindur se nuk do të ma prishte, por ai më vështroi në mënyrë të tillë, thuajse kisha nxjerrë nga goja ndonjë budallallëk me brirë.

— Në brigadën e Merushes?!... Ç'është kjo Merushë?

U mundova t'ia kujtoja sadopak dhe ia dola mbanë. Kryetari i nderuar tundi kokën i pakënaqur dhe mori një shprehje të rëndë e të zymtë.

— Aha, ajo Merushja! Ç'është e vërteta, Merushen e kishim brigadiere të zonjën, mirëpo ajo...

Kur dëgjova këto fjalë dhe tonin e zvargur me të cilin m'i tha, m'u drodh zemra. Të kujtohet se ç'vazjë ishte, apo jo? Apo s'ishte punëtore e shkuar punëtores! E dënova veten që, megjithëse padashur, i lëndova plagën që kishte filluar t'i zinte kore kryetarit të varfër... Duke u munduar të fshihja dhembjen dhe tronditjen time, iu drejtova me gjysmë zëri:

— Po si ndodhi?...

Kryetari nuk m'u përgjigj menjëherë. E kishte të vështirë, s'i thonë shaka! Pastaj, si thithi cigaren fort, ma ktheu:

— Po ja, mori lejen e lindjes, dhe...

«E gjora! — mendova. — Nuk paska arritur të shijojë as kënaqësinë që i jep mëmës fëmija e parë!» Vetëm ti, që e di se ç'zemër delikate e të ndieshme që kam, mund ta marrësh me mend gjendjen time shpirtërore në atë çast. Megjithatë e bëra mendjen top që, sapo të përfundonte së treguari kryetari, të veja për kryeshëndoshë në familjen e saj.

— Po pastaj, ç'ngjau? — u bëra i fortë unë.

— E ç'të ngjiste tjetër? — ma ktheu nervoz dhe si i

bezdisur kryetari. — Ajo mori lejen e lindjes, dhe... Dhe në, në vend të saj vendosëm Qatipin. Ajo lindi djallë dhe e mbaroi lejen, po a ishte e hijshme e burrërore nga ana jonë që të hiqnim Qatipin e të vinim përsëri atë?

Çehreja më erdhi në vend. Paska qenë llafi për detyrën e brigadieres e jo për Merushen vetë.

— Po tani me se merret ajo? — e pyeta me zemër disi të lehtësuar.

— Tani Merushen e kemi bukëpjekësen më të dalluar të kooperativës! — ma ktheu gjithë mburrje kryetari.

Pyetjes sime, nëse kishin ndër mend ta kthenin Merushen në detyrën e saj, kryetari iu përgjigj gjithë sinqeritet:

— Si të të them, o byrazer, është mesele e ngatërruar kjo puna e femrave. Se ajo, në mos sivjet, vitin tjetër ka për të lindur prapë. E prapë do të marrë leje lindjeje... Kurse me Qatipin e ke mendjen të fjetur, — e mbylli me një dozë humori ligjeratën e tij.

Më erdhi keq për spostimin e një brigadiereje të tillë aq të zonjën, po ç'mund të bëja, o Hysen vëllai? Të të kisha ty me vete, do t'ia skuqje pak kryetarit me atë majën e lapsit tënd, por ja që ti nuk m'u ndodhe pranë këtë herë. Sidoqoftë, më ngushëlloi fakti që kooperativa e tyre kishte brigadiere të tjera jo më pak të zonjat se Merushja, prandaj i thashë:

— Nejse, po vete të punoj në brigadën e asaj vajzës së re, asaj topolakes... Si e quanin atë?

— Mos e ke fjalën për Selvien?

— Tamam, për Selvien! — m'u kujtua menjëherë emri i saj.

— Ah, Selvie, Selvie! — tundi gishtin kryetari në adresë time, sikur unë të isha Selvia. — Na e punoi paq Selvia. Dukej e urtë dhe e turpshme si një qengj, por

paskesh qenë thëngjill i mbuluar ajo! Qysh atë vit që e zgjodhëm brigadiere, krisi e u martua!

— Mos u martua në ndonjë kooperativë tjetër? — pyeta unë.

— Ku ta gjenim këtë të mirë! — ma ktheu kryetari i pezmatuar.

Nga goja e tij mësova se, pa dëshirën e prindërve të saj, një ditë me diell, Selvia paskesh vajtur në shtëpinë e djalit që donte, duke futur në sëkëlldi jo vetëm thashe-themexhinjtë e fshatit, por edhe vetë kryesinë e kooperativës.

— Të flasim me zemër të hapur, o bukë e vjetër, a mund ta mbanim ne një brigadiere të tillë? — kërkoi të shfaqësohej para meje kryetari.

— Po ajo nuk bëri ndonjë turp — e kundërshtova. — Mori atë që deshi, dhe...

— Sidoqoftë, opinioni... — mblodhi krahët ai.

U mundova t'i mbushja mendjen se kishin vepruar gabim, mirëpo duhej të zbrazja timen e tënden bashkë, që të mbushja përgjysmë kokën e tij!

E, që t'i bie shkurt llafit, nga tri brigadiere krahëshpërvjela, që lamë ne këtu e tre vjet të shkuara në Pinjal, nuk gjeta asnjë.

Por meseleja nuk mbaron me kaq. Më e bukura ishte se vetëm pak ditë pasi shkova unë në Pinjal, kryetari u shkarkua nga detyra e në vend të tij kooperativistët vunë... E di kë? Merushen, o Hysën, Merushen!

THESI

Shumë arra prodhoi sivjet kooperativa jonë bujqësore. Për dy javë rresht dy brigada u morën me vjeljen, mbledhjen dhe transportimin e tyre. Por puna nuk përfundoi me kaq. Nëpër ferra e driza ende kishin mbetur arra, të cilat duheshin mbledhur e dërguar në magazinë. Ndër kooperativistët e tjerë brigadieri ngarkoi me këtë detyrë edhe Sefën.

— Sefë, o Sefë! — i tha brigadieri atij, kur vuri re se thesi që kishte pranë ishte mbushur gjer në grykë. — Merre këtë thes me arra dhe shpjere në magazinë.

— Shumë i rëndë më duket, shoku brigadier!

— Hajt, Sefë, hajt, se nuk i ka më shumë se tridhjetë kilogram! Shpjere shpejt në magazinë, peshoje dhe eja më thuaj sa kilogram erdhi, — tha prerë brigadieri.

Sefa i hodhi edhe një vështrim thesit të fryrë, sikur të desh ta peshonte me sy e pastaj, si shfryu faqet e vuri mbi kurriz. I kërrusur u vu për udhë. Eci vetëm disa metra e pastaj qëndroi të pushonte një copë herë. Si u çlodh pak, u afrua dhe hapi grykën e thesit.

— Heeee, këto qenkan arra! — tha me vete. — Pa t'i provojmë njëherë! — Dhe, si tha këto fjalë, futi dorën në thes, nxori ca kokrra dhe theu njëren prej tyre. — More, more, si letër cigareje e paskan lëvozhgën të uruarat! — tha pastaj.

Si bëri këtë zbulim, vështroi andej-këndej në rrugë, u ul këmbëkryq, vuri një grumbull arra përpara dhe filloi t'i thyente e të përtypej ritmikisht. Në këtë punë e gjeti Selimi, i cili sikur mbiu nga toka.



— Punë të mbarë, Sefë! — i tha si me shejtanllëk. Tjetri, i zënë në befasi, nuk iu përgjigj dot menjëherë, pasi arrat i vajtën shtrembër dhe e mbyti një kollë e fortë.

— Ç'po bën këtu? — pyeti Selimi.

— Ja, ç'të bëj? — ia ktheu Sefa duke fshirë sytë e përлотur nga kolla. Më ngarkoi brigadieri të shpie këtë thes me arra në magazinë, po a ka burrë që e lëviz nga vendi? Ky ka më shumë se tridhjetë kilogram!

— I ka ore, si nuk i paska! — i mbajti ison Selimi dhe u afrua mbi grykën e thesit. — Hajde, Sefë, hajde! Këto qenkan arra, vëlla! — i qeshi nuri.

— Ulu, Selim, ulu e thyej ndonjë kokërr! — e ftoi zemërgjeri Sefë!

Selimi nuk priti t'i thoshte për herë të dytë. U ul edhe ai këmbëkryq, vuri një grumbull arra përpara dhe filloi të përtypet.

— Tani më fal, se po më presin në fushë e kush e dëgjon atë brigadieren time! — tha kur i dha fund grumbullit që kishte përpara.

— Merr ca kokrra me vete, merr! — u ngrit në këmbë Sefa dhe ia mbushi dy xhepat e xhakëtës.

— T'u rritët nderi, Sefë! — e uroi Selimi ndërsa po largohej.

— Nder paçim, o Selim, se pa nder nuk jetohej, jo! — gjegji Sefa.

Sefa vazhdoi të përtypej. Nuk kishte përse të nxitohej. Dita kishte ende kohë për t'u thyer. Pikërisht kur vendosi të vihej në udhë, aty pranë kaloi Nifja.

— Çfarë ke në atë thes, o Sefë?

— Arra, moj Nife, arra, po më këputën fare! — ia ktheu ai.

— Do të të ndihmoja me gjithë qejf, po nuk kam kohë — tha ajo dhe bëri të largohej.

— Na, moj Nife! Merri nja katër a pesë kokrra, merri.

— Nuk më hahen, jo. — kundërshtoi ajo. — Po a nuk më thua, Sefë të tuat i ke këto arra?

— Tonat, bre Nife, tonat janë!

— Domethënë, të kooperativës?

— Merr, bre Nife, merr kur të thonë! — e nxiti Sefa dhe i zgjati një grusht me arra. — Pse, pak ka kooperativa?

— Me mallin e kooperativës tregohesh havarda ti, ama, po t'i kesh të tuat, një kokërr s'të jep! Hiq dorë, Sefë! Akoma s'e ke të qartë se duke dëmtuar pronën e kooperativës, dëmton pronën tënde? — i foli ashpër Nifja dhe, si i mori arrat nga grushti i tij e i zbrazti përsëri në thes, u largua.

— Hy, ty mos të rëntë një kokërr në sqep, piperkë! — shfryu Sefa. — Po s'ke faj ti, jo, fajin e kam unë që kërkoj të të bëj nder.

Si hungëroi një copë herë të mirë, bëri të ngrinte thesin kur pa se drejt tij po vinte Agimi, i biri, që po kthehej nga shkolla.

— U lodhe, baba? — e pyeti.

— U këputa fare, po e di ç'ke ti? Ik vrap në shtëpi e merr një trastë!

— Shkova, baba! — ia ktheu djali, i gatshëm të ndihmonte të atin në transportimin e thesit me arra.

Sefa s'kishte mbaruar së ngrëni kokrrën e tretë të arrës kur Agimi u kthye me trastë në dorë. Sefa i mori trastën, vështroi andej-këndej e pastaj me shpejtësi filloi ta mbushte me arra.

— Merre tani e shpjere në shtëpi. Veç mos kalo drejt rrugës, po bjeri arave — i tha të birit.

— Jo, baba, arrat e kooperativës nuk i çoj në shtëpi unë — kundërshtoi Agimi. — Unë pandeha se...

— Hajt, more! U bëre edhe ti të më japësh mend mua! Nisu, në mos po krisi huri! — i bërtiti i ati dhe, si i vuri trastën mbi kurriz, i dha një të shtyrë.

Desh s'desh, Agimi filloi të zvarrisë këmbët. Sefa i hodhi një sy thesit. Ai tani pothuajse ishte përgjysmuar. Pa ndonjë vështirësi e vuri mbi kurriz dhe vrapoi drejt magazinës. Mbaroi punë atje dhe u kthye në frontin e punës.

— Hë, Sefë, sa kilogram erdhi thesi me arra? — e pyeti brigadieri.

— Njëzet e një kilogram, shoku brigadier!

— Njëzet e një kilogram? — hapi sytë brigadieri.

— Hë, pra, aq. Nuk lëvizte peshorja as andej, as këndeje. Kështu në të parë dukej goxha thes ai, po paske-shin genë pambuk të lehta. . .

— E ke gabim, bre Sefë. Ai thes me arra duhej të kishte jo më pak se tridhjetë kilogram!

— Sa? — tha Sefa dhe ia dha një të fishkëllyeri. — Hej, ç'na kënaqe, o shoku brigadier! Pse, si thua ti, kam fuqi unë të mbaj tridhjetë kilogram mbi kurriz?

Brigadieri mbeti mëdyshas. Fjalëve të Sefës nuk mund t'u besonte, po ama edhe vetë kishte faj që ia kish-te dhënë ashtu qesim thesin me arra. Po si të vepronte ndryshe? Një thes me arra ishte dhe peshore s'kishte aty pranë.

— Po më çudit, për besë! — tha pastaj duke mble-dhur supet. — Një gjë është në këtë mes: ose peshorja nuk është në rregull, ose. . . Pa eja, eja të shkojmë bashkë andej nga magazina.

Tha këto fjalë dhe ai para e Sefa pas, u nisën drejt magazinës.

— More Zeqir, — i tha magazinierit kur arritën atje, — sa kilogram erdhi thesi me arra që të sollti Sefa?

— Njëzet e një rrumbullak!

— Hë, u qetësove, brigadier? — u krekos Sefa, — S'më ke nga ata që më mendon mua, prandaj herët e tjera mbaj gojën!

Brigadieri mblodhi supet e bëri të largohej kur pa se drejt magazinës po vinte një djalë me diçka mbi kurrriz! Si u afrua edhe ca, dalloi që ishte Agimi, djali i Sefës.

— Agim, çfarë ke në atë trastë? — e pyeti.

— Arra...

— Ku i more?

— I mora ... Ia mora babait, që t'i ndihmoja, se ishte thesi shumë i rëndë... — tha djali prush në fytyrë dhe vështroi të atin.

— More, more, po ky, ç'na qenka fryrë kështu? — u dëgjua zëri i magazinierit.

— E ka qerasur Sefa me arrat e kooperativës! — tha Nifja, që po vinte me Selimin përpara, me xhepat të fryrë si kacek.

— Unë e dija se i kishte të tijat, pa po ta dija se ishin të kooperativës, e bëja për pesë para! — u mundua të dredhøjë Selimi, duke zbratur xhepat.

— Hë ty t'u bëftë njëra, t'u bëftë! — mërmëriti Sefa.

— Hë, more Sefë, i paska pasur tridhjetë e ca kilogram thesi, apo jo? — tha brigadieri.

Sefa nuk i ktheu përgjigje, por uli kokën sikur desh të lexonte diçka të shkruar në tokë. Pastaj vështroi të birin dhe, si ndjeu se fytyra po i merrte zjarr, e mori nga dora atë dhe u largua ngadalë, si të kishte ende mbi supe thesin me arra...

MËSALLA ME DY FAQE

Bejkushi rrëshqiti si hije dhe doli nga zyra. Kur u gjend në rrugë, psherëtiu i lehtësuar. Nuk e kishte parë asnjë nga kolegët e tij. Për fat të mirë edhe shoku Nasi, shefi i tij direkt, kishte vajtur për një problem andej nga komiteti, kështuqë ishte i lirë. Jo për gjë tjetër, po a kishite burrë që i duronte fjalët e tyre? Sikur nuk e dinte ai se sa rëndësi ka katërqind e tetëdhjetëminutëshi! Por ja që njeriu ka edhe halle dhe dashje pa dashje i duhet bërë bisht nganjëherë. Natyrisht, këto mendime Bejkushi nuk do t'i parashtronte në referatin që i kishin ngarkuar të pregatiste pikërisht për këtë problem. Këto kishin të bëjnë vetëm me hallet dhe nevojat që u lindin njerëzve. Ja, për shembull, vetë Bejkushi kishte disa ditë që përpiquej të vizitonte një të njohurin e tij të shtruar në spital, mirëpo s'kishte gjetur që s'kishte gjetur kohë. Sot duhej vajtur patjetër.

Rrugës u kujtua se nuk bënte të shkonte duarbosh tek i sëmuri. Me këtë mendim në kokë u drejtua nga dyqani i frutave, që ndodhej në qoshe të rrugës. Kur arriti atje, pa se dyqani ishte i mbyllur. Tek dera e dyqanit priste një klient.

— Mbyllur është? — e pyeti klientin Bejkushi.

Tjetri, pa folur asnjë fjalë, i tregoi drynin që varej në derë.

— Epo, ky është kulmi! — mori flakë Bejkushi. — Flisni, ju lutem shumë, nuk ta bëjnë borxh ca shitëse të tilla? E mbyllin dyqanin kohë e pa kohë!

Klienti e vështroi njëherë nga poshtë lart dhe i ktheu kurrizin. Veprimi i tij e tërboi edhe më tej Bejkushin, i cili vazhdoi edhe më me zjarr:

— Po këta të çmendin fare, more! Këtyre, jo një fletërrufe po të kesh mundësi t'i pushosh në vend, dhe me ceremoni, bile!

— Kushedi si e ka patur hallin, more shok — ia ktheu qetë tjetri.

— Halle në orar të punës?! Ku është parë një gjë e tillë?! Pse ne të tjerët, mos vallë nuk kemi halle? — vazhdoi një oktavë më lart Bejkushi. — Më falni, shok, por nuk bëni aspak mirë që merrni nën mbrojtje njerëz të tillë! Duhet ta dini se, sipas studimeve të bëra posaçërisht, shkelje të orarit të punës ngjasin pikërisht sepse disa njerëz e bëjnë njërin vesh të shurdhër e njërin sy qorr! Apo mos edhe ju...


Unë jam në turnin e dytë! — ia ktheu i mërzitur klienti dhe u largua dy a tri hapa. Siç duket mendoj se rruga më e mirë ishte të mos i përgjigjej fare.

Si shfryu një copë herë të mirë me veten e tij, Bejkushi bëri të largohej. S'kishte bërë veçse pak hapa, kur një shoqe iu afrua dyqanit me të shpejtë, e hapi dhe u fut brenda. Bejkushi u kthye nga rruga dhe u turr drejt banakut.

— Më falni, ky dyqan është shtetëror apo privat? — iu drejtua gjithë ironi shitëses, e cila ndërkohë po vish-te bluzën.

— Ju lutem, ç'është kjo pyetje? — shtangu e habitur shitësja nga fjalët e tij.

— Po atëhere ç'ma hapni e ma mbyllni dyqanin kur



t'ju teket, thua se jeni pronare? Mos vallë nuk e keni të qartë se jeni shërbyese e popullit?

Shitësja mbeti si e hutuar para këtij sulmi të stuhishëm. Kishte rastisur që t'i tërhiqte vërejtje edhe vetë drejtori i saj, por toni i këtij njeriu ishte me të vërtetë tronditës.

— Ju keni shumë të drejtë, por unë... — u mundua të sqarojë ajo.

— Unë, natyrisht që kam shumë të drejtë, kurse ju vazhdimisht veproni shtrembër! A e dini ju se ç'bëhet sot në vendin tonë për pak minuta? Për pak minuta sot kryhet puna që është kryer gjatë gjithë vitit 1938, për pak minuta. . .

Toni i Bejkushit sa vinte e bëhej më autoritar. Atij i dukej vetja se po referonte para një auditori të gjerë. Shitësja e dëgjonte tërë respekt, me fytyrën të skuqur si ato mollët që kishte reklamuar në vitrinë. Klienti tjetër, kur pa se Bejkushi i frymëzuar nuk kishte ndër mend të pushonte, iu drejtua shitëses:

— Shoqe, dy kilogram mollë, ju lutem!

— Mos u mërzit, ti shok! — iu kthye Bejkushi atij.
— Është më mirë të prisni sot pak minuta, se sa të vini e të prisni vazhdimisht para dyqanit me orë të tëra!

— Më falni, po unë. . . — mezi munda të belbëzojë ajo.

— Nuk ju fal hiç! — shpërtheu edhe më tej Bejkushi, thua se jeta e saj varej në dorën e tij. — Oj kjo! — iu kthye përsëri klientit tjetër, i cili po e vështronte në mënyrë të dyshimtë. — Vjen ma hap e ma mbyll dyqanin e shtetit kur t'i teket, ke parë kështu ti? Ne kalojmë net pa gjumë për të gjetur pikërisht shkaqet e këtyre. . .

— Shoku klient, ju nuk po më lini t'ju spjegoj se...
— filloi të humbasë durimin edhe shitësja.

— Nuk e dua, nuk e dua atë spjegimin tuaj! — u thartua në fytyrë Bejkushi. — U ngjirëm duke folur për këtë të uruar katërqind e tetëdhjetëminutësh, po kujt t'i flasësh? Edhe ato mollë që kërkojmë të blejmë, na i nxirrni nga hundët!

— Mos deshët gjë mollë, shok? — tha shitësja.

— Ta merr mendja që dua! Më pesho shpejt një kilogram dhe do ta shohim këtë punën tënde!

Shitësja mori një qeskë e filloi ta mbushte me mollë.

Klienti tundi kokën, ndërsa Bejkushi se ç'filloi të thotë diçka të pakuptueshme nëpër dhëmbë.

Ndërkohë në derë u duk një person tjetër. Ai shikoi njëherë brenda në dyqan dhe, si njohu Bejkushin, u fut brenda.

— Hë, Bejkush, ç'paske dalë? — iu drejtua atij.

Bejkushi bëri një rrotullim nëntëdhjetëgradësh dhe u gjend ballë për ballë shefit të tij, shokut Nasi. Në fillim u trondit, por pastaj e mblodhi veten menjëherë.

— Ja, shoku Nasi, si t'ju them... Shkelje, kudo shkelje të disiplinës proletare në punë! Ja, për shembull, kjo shitësja sapo e hapi dyqanin! Dola për pak minuta nga zyra që të konkretizoj referatin që më ngarkuat, dhe ja...

Duke thënë këto fjalë, Bejkushi i futi krahun shefit të tij dhe filloi ta tërhiqte drejt derës së dyqanit. Ata po kapërcenin pragun, kur shitësja e mbaroi peshimin e mollëve dhe iu drejtua Bejkushit:

— Urdhëroni, shoku klient!

Bejkushi bëri sikur nuk e dëgjoi dhe bëri të ecë, ndërsa shoku Nasi u kthye nga shitësja.

— Ç'janë ato? — pyeti shitësen që kishte zgjatur qesen me mollë në drejtim të tyre.

— Mollët që sapo porositi shoku juaj! — tha gjithë nënkuptim shitësja.

Shoku Nasi buzëqeshi hidhur, i hodhi një shikim Bejkushit e pastaj i tha:

— Rast më të freskët e më konkret se ky s'keni ku të gjeni, shoku Bejkush! Futeni të parin në referat!

Ai tha këto fjalë e u largua, ndërsa Bejkushi mbeti në mes të dyqanit. Klienti tjetër i hodhi një shikim nga koka të këmbët dhe u kthye nga shitësja të bënte porosinë.

ZHDËMTIMI

Minai, shefi i repartit, kishte mbështetur bërrylat mbi tryezë, ndërsa me dy pëllëmbët po shtrëngonte kokën. Vlonte i tëri nga zemërimi. Sapo ishte verifikuar se magazinier Rapushi ishte bërë shkaktar për daljen jashtë përdorimit të disa materialeve. Drejtori kishte dhënë urdhër që materialet e dëmtuara të zhdëmtoheshin përnjëherësh. Minai ishte në udhëkryq. Gjynah për materialet e dëmtuara, gjynah edhe për Rapushin e gjorë...

«He, Rapush, Rapush! — punonte truri i Minait. — Si nuk vure mend, a derëbardhë! Edhe vitin që kaloi e njëjta punë me ty! Atëherë bëmë si bëmë dhe e kalove lumin, po sivjet, ehe, sivjet...»

Papritur ndjeu një sëmbim. Vuante nga dobësia e zemrës. Sidomos kur merrte lajme të kësaj natyre. Mirë kishte thënë dikush me të qeshur se «Shoku Mina e ka zemrën të ndjeshme si të pulës».


«Bëra gabim që i çova fjalë të paraqitet menjëherë — mendoj pastaj. — Me këto nerva që më kanë hipur... Po të jetë i zgjuar, nuk vjen tani... Ndryshe e piu e zezë! Do të tregohem i pamëshirshëm!»

I zhytur në këto mendime ai s'e ndjeu fare trokitjen dhe hapjen e mbylljen e derës.

— Më kërkuat, shoku Mina? — iu drejtua me zë të mekur i porsaardhuri.

Minai u shkund, ndërroi pozicion dhe hodhi vështrimin përpara vetes. Para tij qëndronte Rapushi.

«Ç't'u desh që erdhe në këtë furtunë, o lumëmadh,



ç't'u desh!» mendoi, ndërsa i foli me të rreptë:

— Hë, erdhe ti?

Rapushi tundi vetëm kokën pa e vështruar në sy.

— Mirë. Për dëmtim të pasurisë së përbashkët do të përgjigjesh një për një, me lekë në dorë! Ik tani!

I foli shkurt, prerë, qartë. Më mirë kështu. Llafet e tepërta janë fukarallëk. Tjetri, kur dëgjon pak fjalë e kupton që vendimi është i formës së prerë dhe largohet.

— Shoku Mina, ju keni të drejtë... bile shumë të drejtë... Fundja ju urdhëroheni nga dikush tjetër, por mendoni ju lutem — dëgjoji zërin e mekur të Rapushit.

— Ç'të mendoj, more? Se mos mendove ti për pronën e përbashkët që të mendoj edhe unë për ty? Dëmin do ta paguash një për një, dhe pikë!

«Vërtet e zgjata ca, por i fola ashpër, ama!» mendoi.

Mirëpo, megjithëse Minai i vuri pikë problemit, Rapushi e hapi përsëri gojën, këtë herë me një zë që të këpuste shpirtin.

— Mendoni, shoku Mina, i thonë gati dy muaj rrogë... Ju keni të drejtë, bile shumë të drejtë, po kalamajtë e gjorë...

— S'ka kalamaj — tundi dorën nervoz Minai sikur donte të largonte ndonjë mizë që po e bezdiste. — Ik, paguaj paratë!

— Kam katër, shoku Mina, katër kalamaj, që presin si zogjtë në fole...

«Si tha, katër kalamaj?! — mendoi dhe ndjeu për së dyti një sëmbim në zemër. — Ah, kjo dobësia e zemrës! Duhet të bëj një vizitë tek mjeku kardiolog. Sidoqoftë, katër kalamaj janë shumë. Bëj mirë t'ia ul ca. Për hir të kalamajve, xhanëm, e jo të këtij shpërdoruesi!»

— Të jetë e para herë dhe e fundit kupton? — i tundi gishtin pastaj, duke u munduar të marrë një shprehje

sa më të ashpër në fytyrë. — Shko në arkë dhe paguaj shtatëdhjetë përqind të vlerës së dëmtuar, qartë?

— Shoku Mina, po unë edhe pak kohë e martoj djalin e madh, dhe. . .

— Të të trashëgohet! — qëndroi i pamposhtur Minai dhe mori penën në dorë me një paraqitje prej indiferenti.

— Falemnderit, shoku Mina, shumë falemnderit prej jush. Fundja ju s'keni faj, kështu ju kanë urdhëruar. Unë e njoh shpirtin tuaj, shoku Mina — u përkul tjetri në drejtim të tij.

Minai ishte përkulur dhe bënte sikur po shkruante diçka, por mendjen tek fjalët e tij e kishte. Kur Rapushi mbaroi së foluri, ngriti veshët se mos dëgjonte hapat e tij tek do të largohej, por asgjë. Kur ngriti kokën me rrëmbim, që t'i thoshte ta linte të qetë, i pikoi në zemër. Rapushi kishte ulur kokën për tokë si ata fëmijët fajtorë kur presin qortimet e baballarëve.

«Ah, kjo dobësia e zembrës!» mendoi Minai dhe u shkreh i tëri para qëndrimit të përlulur të tjetrit.

— Dëgjo këtu! — iu drejtua me një ton të zbutur. — Pesëdhjetë përqind e vlerës së materialeve të dëmtuara nuk është shumë, si thua? Dhe tani ik, se jam i zënë!

— Edhe me kaq, shumë falemnderit prej jush, shoku Mina. . . Ju edhe kaq bëtë shumë, megjithëse. . . — pshe-rëtiu Rapushi dhe, si i hodhi një sy derës, vazhdoi: — Pata vendosur që dasmën e tim biri ta mbanim mend, por ç'e do. . . Fundja, koka bën, koka pëson, shoku Mina! Të mos më kishte rënë ky hall në kokë do të kisha ftuar disa nga kolegët e do ta digjnim fare, kurse tani do të mjaftohem vetëm me ju e me ndonjë. . .

«Je tepër shpirtvogël! — i tërhoqi vëmendjen vetes Minai. — Kështu siç po sillesh ti me këtë të mjerë, i ka hije veç një kanibali!»

— Edhe njëherë shumë falemnderit prej jush, sho-

ku Mina! — tha Rapushi gati i ngashëryer dhe kapi dorezën e derës.

Megjithëse e kapi shumë mirë drithërimën e zërit të tij, Minai qëndroi i fortë. Ja, Rapushi do ta kalonte pragun e derës dhe kjo torturë do të merrte fund.

«Epo, pesëdhjetë përçind e vlerës nuk është shumë, ta marrë e mira ta marrë! — mendoj. — Pastaj ai vetë tha që koka bën, koka pëson!»

Duke menduar kështu, dëgjoi zhurmën e lehtë që bëri hapja e derës. Ngriti kokën paksa, që të vështronte Rapushin tek po dilte, kur sytë e tij ndeshën në sytë e njomur të Rapushit. «Mos! — i thirri vetes. — Mos u jep!» Por Minai nuk mund të mbahej më.

— Na, Rapush, shoku Rapush! — belbëzoi i prekur sa s'thuhet. — Për kokën tënde, mos... Nuk bën kështu, Rapush, nuk bën...

— Falemnderit prej jush, shoku Mina! — tha Rapushi duke iu dridhur supet.

— Mirë, mirë, hajde. Mbylle derën, se po e mbyllim edhe këtë çështjen e zhdëmtimit — u dorëzua më në fund Minai — Fundja...

S'e mbaroi dot fjalën. Krahët e fuqishëm të Rapushit e mbërthyen si ndonjë darë dhe ai ndjeu se këmbët iu shkëputën nga toka. Fytyra e Rapushit, pak më parë e vrrarë dhe e pikëlluar, shkëlqente e tëra nga gazi dhe hareja.

— Ju jeni shpirt njeriu, shoku Mina, ju jeni... — vazhdonte t'i shtrëngonte duart Rapushi.

Papritur, në derë u dha drejtori. Rapushi, që i kish-te kthyer kurrizin derës, nuk e vuri re dhe vazhdonte t'ia shtrëngonte e t'i tundte duart Minait:

— Nuk di si t'jua shpërblej, shoku Mina, nuk di...

Ndërkohë ndjeu një dhëmbje të fortë në këmbë dhe u mpraps i tmerruar. Këpuca e rëndë e Minait, që e kish-te vënë re drejtorin në derë, i kishte mëshuar fort.

— Ç'janë këto shtrëngime duarsh, Mina? — iu drejtua drejtori.

— Po ja... si t'ju them... unë bisedova me Rapushin dhe... dhe mora vesh se për pak kohë marton djalin... — u mundua të buzëqeshë Minai.

— Ashtu? Të trashëgohet! — uroi drejtori — Po për zhdëmtimin e materialeve, ç'thotë? — shtoi.

— Më lejoni që qysh sot, bashkë me shokun Mina, t'ju ftoj në dasmë, shoku drejtor! — ndërhyri shpejt e shpejt Rapushi.

— Ka kohë puna e dasmës, Rapush — tha drejtori e pastaj iu kthye përsëri Minait: — Pra, ç'u bë me materialet e dalura jashtë përdorimit? A bindet Rapushi për zhdëmtimin?

— Si urdhëron, bindet. Bile ai erdhi vetë këtu, por unë, duke menduar se ai...

— Domethënë të erdhi keq?

— Jo po, meqë ka dasmë...

— Mirë, dakord. Ne, si drejtori, nuk kemi ndonjë kundërshtim. Vlerën e materialeve paguajeni bashkë — tha drejtori dhe doli.

Minai mbeti si i ngurosur në mes të zyrës. Instinktivisht vuri dorën në xhepin ku mbante portofolin. Pastaj lëvizoi nga vendi dhe iu drejtua Rapushit:

— Hë, ç'më rri ashtu? Nuk e more vesh se ç'të thashë? Dëmin do ta paguash një për një, me lekë në dorë! Ik tani! — dhe shpejtoi i hapi derën.

— Shoku Mina... po unë... — tha përvaishëm Rapushi.

— More tregoja ndonjë tjetri ato, se tek unë nuk të pinë ujë! — tha i vendosur dhe i tregoi derën Minai.

Për herë të parë nuk ndjeu asnjë sëmbim në zemër. Kur Rapushi kaloi kokulur para tij, Minai preku edhe një herë me dorë vendin ku mbante portofolin.

GODITJE NË SHENJË

Ka një copë herë të mirë që po ndjek për së largu tre fëmijë: Lulin, Lalin dhe Lilin. Po sillen sa në një vend në tjetrin. Me sa duket, nuk po gjejnë një vend të përshatshëm për të kaluar kohën e tyre të lirë. Lili mban një goxha top llastiku nën sqetull, kurse Luli i ka vënë një alamet spangoje bilbilit të tij prej llamarine dhe e ka varur në qafë. Ka marrë atë pamjen e rëndë që marrin të gjithë gjyqtarët para se të fillojë një ndeshje futbollit. Lali i udhëheq. Më në fund qëndruan në një vend që nuk mund të quhej as shesh, as rrugë kalimi.

— Si thoni, fillojmë këtu? — tha i pari Lali.

— Vend më të mirë nuk kemi ku të gjejmë — ia ktheu Lili dhe, si për të vulosur mendimin e tij, lëshon topin për tokë e fillon të bëjë kabime me të.

Vetëm Luli, me sa duket, nuk është i një mendimi me shokët e tij.

— Ç'thua, Luli? — e pyet Lali.

— Po edhe këtu është rrugë e kalojnë njerëz — tha ai, — Veç kësaj, ka rrezik të thyejmë ndonjë xham.

— Gjer tani kemi ndërruar tri vende, — tha Lali. — Këtu ka pallate, atje kalojnë njerëz, matanë thyejmë llampat e ndriçimit të rrugës! Po ku të luajmë atëherë, në taracat e pallateve?

— Këtu do të luajmë, këtu! — këmbënguli Lali. —

Na iku koha duke u sjellur vërdallë. Ti Luli do të qëndrosh portier, mirë?

— Mirë, mirë, veçse...

— Kur unë dhe Lali të kemi bërë nga pesë gjuajtje në portë, atëherë ai që do të shënojë më pak gola do të hyjë portier.

Gjetën dy gurë dhe bënë portën. Lali numëroi njëmbëdhjetë hapa larg portës dhe vendosi topin. Luli u fryu njëherë duarve dhe zuri pozicion në portë, kurse Lili pregatitej të gjuante i pari. Rregulloi topin mirë e bukur mbi një grumbull të vogël dheu dhe mori vrull. U largua disa hapa të mira nga topi. Kur po lëshohej për të shkelmuar topin, u përplas me një plak që sapo doli nga rrugica pranë.

— Avash, more djalë, se më dërrmove — thirri plaku.

— Më fal, xhaxho... unë... — kërkoi të shfajësohej Lali.

— Pse, luhet me top në mes të rrugës? Çfarë u bë këtu, fushë topi?

— Po ne... s'kemi ku të luajmë gjetkë, xhaxho — tha Lali.

— Nuk është mirë të luani rrugëve — tha plaku duke mos ditur ç'të thoshte tjetër dhe u largua.

Loja, e ndërprerë për pak minuta, rifilloi. Lali i fryu fort bilbilit.

— Prite, Lul! — thirri Lili dhe u vërsul e shkelmoi topin. Me gjithë tentativën e Lulit për ta pritur, topi kaloi fluturimthi mespërmes portës.

— Gol! — shprehu admirimin e tij Lali.

Gjuejtjen e dytë Luli e priti me një hedhje akrobatike.

— Po ti, ç'na duartroket këtu? Pse, në stadium jemi? Pastaj ta marrim vesh: ti je arbitër apo tifoz i Lu-

lit? Le të presë këtë bombën që do t'i lëshoj tani, po deshi!

Tha këto fjalë dhe mori vrull përsëri. Si u largua disa hapa nga topi, filloi t'i afrohej me shpejtësi të rru-feshme. Topi, i shkëlmuar me shumë forcë, kaloi mespër-mes portës së mbrojtur nga Luli dhe vajti u përplas pas një dritareje të pallatit pranë. Xhami u bë copë e grimë. Fëmijët u shpërndanë në pikë të vrapit në drejtime të ndryshme. Në çast nga pallati doli një burrë i veshur me pixhama e pandofla.

— More rrugaçë! — filloi të thërriste, duke mos ditur kujt t'i drejtohej, pasi fëmijët ishin zhdukur pa nam e pa nishan. — Nuk keni turp që luani rrugëve? Ç'kujtoni se u bë kjo dritarja ime, portë për të shënuar gola ju?

Si u afrua pak, e njoha. Ishte inxhinier Aristidhi, shefi i urbanistikës në qytetin tonë.

— Ç'ka ndodhur, shoku Aristidh? — e pyeta sikur të mos kisha parë gjë.

— Ç'të ndodhë tjetër? Ja, ca rrugaçë më bënë copë e grimë xhamin e dritares së kuzhinës!

— Gjëra që ngjasin — u mundova ta ngushëlloja.

— Epo, kur ke të bësh me fëmijë të tillë. . .

— Nuk jam i një mendjeje me ju, shoku Aristidh. . .

— Si?! — shqeu sytë ai. — Ju po i merrni në mbrojtje ata që s'dinë gjë tjetër veçse të thyejnë xhamat e botës? Bukur besa! Mos vallë, sipas jush, ata xhagajdura, vepruan mirë?

— Natyrisht nuk vepruan mirë, veç ata nuk janë as rrugaçë e as xhagajdurë, por djem të mirë, të cilët duan të dëfrenjë në kohën e lirë.

Një buzëqeshje ironike stolisi fytyrën e tij.

— Të dëfrenjë? — qesëndisi me fjalët e mia. Të dëfrenjë duke thyer xhamat e dritares sime dhe unë me kalamajtë të plevitosem gjersa t'u teket shokëve të komu-



nales për t'i vendosur? I bukur dëfrim ky! Ju doni të thoni...

— Dua të them se ai top llastiku, i shkelmuar nga ata fëmijë, padashur goditi në shenjë. Ky rast duhet t'ju vlejë si një sinjalizim nga ana e tyre, për të marrë masa urgjente që krahas blloqeve të pallateve të mendoni edhe për terrenet sportive të fëmijëve!

Shoku Aristidh turfulloi një herë dhe, duke mos ditur ç'përgjigje të më jepte, filloi të tërhiqte pandoflet drejt hyrjes së pallatit.

Nga qoshja e pallatit u zgjatën tri koka me leshra të shpupurishura. Luli, Lali dhe Lili i kishin ngulur sytë si shigjeta tek topi i llastikut, që prehej pak më tej.

KOMSHIU QË HAPTE VRIMA...

Nga komshiu i parë, Zeneli, gjynah të qahem. I kish-te të rrallë shokët. Gjatë tetë vjetëve që banuam me apartamentet përballë njëri-tjetrit, një fjalë të keqe nuk shkëmbyem në mes tonë. Me një fjalë ishte komshi për kokë të komshiut, dhe pikë. Mirëpo në krye të tetë vjetëve, Zeneli u transferua. «Epo mirë — mendova iku. Zeneli, do të vijë një komshi tjetër, ndofta edhe më i mirë!»

Dhe komshiu i ri erdhi. Ishte një alamet burri, trupin e të cilit do ta kishte zili gjith secili. Në fillim, nuk solli as plaçkat, as familjen. Solli vetëm një krevat për vete. Sipas fjalëve të tij, më parë do të merrej me rregullimin e disa gjërave në apartamentin e tij.

«Helbete — thashë unë — do të lyejë, do të rregullojë ndonjë bravë, ndonjë...»

Qysh ditën e parë që erdhi, në derën e apartamentit të tij vuri mbishkrimin: «FAMILJA MAKISHTI». Shkurt llafi, komshiu im i ri quhej Zyhdi Makishti.

Ai s'kishte bërë dy ditë që ishte futur në apartament, kur që matanë filloi zhurma. Durova sa durova, pastaj u nervozova sa s'bëhet. U mاتا të shkoja e t'i thoshja që ta ndërpriste atë zhurmë shurdhuese, por e urta Fato, ime shoqe, më ndaloi:

— Mos u bëj fare edhe ti! Ai me siguri ka sjellë plaçkat e shtëpisë dhe po i vendos nëpër vende. Harrove se ç'hoqëm ne gjersa jua gjetëm vendet?

I dhashë të drejtë Fatos dhe e ndala vrapin. Por zhurma vazhdoi me net të tëra. Më e keqja ishte se komshi Zyhdi punonte mbrëmjeve, pasi gjatë ditës ishte në punë. Dalëngadalë filloi të më mësohet veshi me këtë zhurmë. Bile, po të mos dëgjoja gjë, fillonte më hante edhe merak. Shkurt llafi, u ambientova për bukuri.

Një mbrëmje, pasi Fatoja vuri fëmijët në gjumë, u ulëm dhe po diqnim një film në televizor. Që matanë ndihej zhurma e zakonshme, që tashmë ishte bërë pjesë e pandarë e netëve tona. Papritur u ndie një zhurmë tronditëse. Muret dhe dyshemeja nën këmbët tona u lëkundën. Unë dhe Fatoja, me sy të çakërritur, u ndodhëm vetëtimthi në këmbë. Një «natyrë e qetë», që ishte në murin e kuzhinës, u rrëzua me rrapëllimë mbi dysheme. Nga dhoma matanë u dëgjua e qara e fëmijëve.

— Fëmijët! — përmenda i pari dhe vrapova drejt dhomës së tyre. Mbi krevatin bashkëshortor më zunë sytë tre-katër copa tulla dhe disa copëra suvaje. Ngrita kokën dhe i tmerruar zbulova se në mur ishte hapur një goxha vrimë. Llama elektrike tundej si ndonjë lavjerrës.

«Tërmet!» më shkoi vetëtimthi në mendje dhe u bëra gati të rrëmbeja dy fëmijët. I vogli lëshoi një piskamë që më ngjethi mishtë dhe i tmerruar mbërtheu sytë mbi mur.

— Ariu! — tha ai tërë frikë dhe zgjati gishtin nga muri.

Ktheva sytë andej dhe vura re një kokë me leshra të shpupurishur, që më ngriu gjakun.

— Mos ju shqetësova gjë, i dashur komshi? — u mundua të vërë buzën në gaz koka me leshra të shpupurishur.

Vetëm nga zëri e njoha se ishte koka e komshiut Zyhdi.

— Ti?! — u habita.

— Pandeha se në këtë vend kalonte oxhaku, por u



gabova — vazhdoi pa të keq ai. — Po nuk përtove, m'i kalo këndeje ato tullat që ranë mbi krevatin tënd dhe eja të këmbejmë dy llafe.

Ç't'i thosha? Tunda kokën, qetësova fëmijët, mora edhe tullat dhe kalova nga apartamenti i Zyhdit.

Kur hyra atje, pashë se apartamenti i tij ishte kthyer në një kantier të vogël ndërtimi. Mbi parketin e dhomës ishte një tog me llaç. Dera, e cila dikur komunikonte me kuzhinën, ishte përplasur në një qoshe. Vendin e saj e kishte zënë një alamet muri.

— Hë, si të duket? — më pyeti me krenari ai, dhe, si ndeshi në habinë time, vazhdoi: — Më dëgjo mua, se jam specialist i vjetër. Projektet e këtyre pallateve nuk vlejnë as dy pare. Ja, më thuaj ti, për çfarë vlen gjithë ajo lavapjatë në kuzhinë?

— Për të larë pjatat — i thashë dhe vetëm atëherë e pashë se lavapjata ishte zhdukur nga vendi pa lënë gjurmë.

— Kurse unë them se nuk vlen për gjë tjetër, veç për të zënë vendin! — ma ktheu gjithë kompetencë ai.

U përpoqa ta bindja se apartamentet janë mjaft praktike e me kubatura të mjaftueshme dhe se ajo që po bënte ai nuk kishte kuptim, po pse, mbushej koka e Zyhdit?

— Konkretisht — vazhdoi ai duke më zënë për dore si ndonjë fëmijë e duke më nxjerrë në sallon, — e shikon sa të madh e kam sallonin tani?

Me të vërtetë që salloni i tij ishte zmadhuar. Por habia ime nuk zgjati shumë. Pashë se depoja e druve nuk ishte më në vendin e mëparshëm.

— Ajo zinte gjithë atë vend, prandaj e prisha — tha Zyhdit e pastaj, gjithë përçmim, shtoi: — E përse vlen-te ajo? Për hiç gjë. Drutë fare mirë mund t'i mbaj edhe në ballkon.

Për minuta të tëra ai më foli gjithë pasion për adaptimet që kishte bërë e që kishte ndër mend të bënte akoma.

— Vendosa që dhomën e gjumit, si më e madhe që është ta kthej në kuzhinë, por ja që më doli pengesë puna e oxhakut — shtoi me keqardhje.

Hodha sytë dhe vështrova parketin e ndotur gjithë llaç. Vetëm atëherë kuptova përse ankohej shoku që banohte një kat më poshtë, të cilit kishte filluar t'i pikonte tavani.

— E gjeta! — thirri papritur Zyhdriu. — Meqë jam në katin e katërt, në vend të oxhakut, mund të hap një vrimë në taracë.

I entuziazmuar nga mendjemprehtësia e tij, filloi të më fliste me një fantazi që kalonte çdo kufi. Sipas fjalëve të tij, në ballkon, gjatë stinës së dimrit, do të mbante drutë, kurse gjatë verës ballkonin do ta kthente në një parcelë të vogël për perime e zarzavate të freskëta. Për ta shtuar sipërfaqen e kësaj «parcele» më propozoi që murin ndarës ndërmjet dy ballkoneve tona ta rrezonim fare. Me një fjalë kërkonte kolektivizim ballkonesh. Ia hodha poshtë me vendosmëri këtë propozim dhe i thashë:

— Ke biseduar gjë me ata të pasurisë së shtetit për këto ndryshime?

— Ç'bëhesh fare dhe ti! Ç'të bisedoj? — ma ktheu mospërfillës. — Ky apartament është imi dhe bëj ç'të dua me të!

E pashë se ishte e kotë ta zgjasja muhabetin, prandaj u largova. Meqë kishte vajtur vonë, shkova të fle. Sapo kishin filluar të më mbylleshin sytë, kur dëgjova një zë:

— Si thua, të shqetëson kjo vrimë gjatë natës, apo ta mbyll?

Brofa i trembur dhe sytë më ndeshën në kokën e

pluhurosur të Zyhdit, që e kishte nxjerrë tek vrima e hapur në mur.

— Lëre pra! Rregulloje nesër! — i thirra duke mos e mbajtur veten.

Ai më buzëqeshi ëmbëlsisht, më uroi natën e mirë dhe saqaj u zhduk nga vrima.

* * *

Të nesërmen në drekë, kur po kthehesha nga puna, në korridor takova Zyhdin me një alamet tokmaku në njërën dorë e me një palë shkallë në dorën tjetër. E mora me mend se po bëhej gati të hypte në taracë, për të hapur vrimën e oxhakut. Vendosa të mos e lejoja të bënte një veprim të tillë, sikur edhe të kacafytesha me të. U bëra gati të hapja gojën kur dikush tjetër i foli:

— Më falni, ju jeni Zyhdi Makishti?

— Si urdhëron! — ia ktheu buzëgaz Zyhdi dhe i zgjati dorën gjithë dashmirësi kontrollorit të pasurisë së shtetit, që sapo ishte ngjitur në krye të shkallëve.

— Vijnë për kontroll — vazhdoi tjetri dhe bëri për nga apartamenti i Zyhdit. Ky më hodhi një vështrim hetues mua dhe e ndoqi pas kontrollorin. S'kaloi shumë dhe ata filluan të grinden me fjalë. Pas pak kontrollori doli i qetë nga apartamenti, i ndjekur nga Zyhdi, i bërë spec në fytyrë, që thërriste me sa i hante zëri, duke tundur një letër në dorë:

— Si është puna, i dashur? — e pyeta.

— Ke parë kështu ti? — ma ktheu me të bërtitur ai.
— Vjen e më lë fletën e gjobës për hiçgjë, burri i botës! Vetëm e vetëm për ca ndryshime mikroskopike...

Ai bëri poshtë shkallëve duke thirrur e bërtitur, kurse unë u futa në apartamentin tim. Zëri i Zyhdit sa vinte e mbytej, gjersa më në fund u shua fare...

DY
NET
PA GJUMË

Një lajm, sa gazmor aq edhe tronditës, trokiti derë më derë e vesh më vesh e më së fundi, me tërë forcën e tij, u përplas edhe në veshin tim:

- E morët vesh? Nesër dalin divanë të një tipi të ri!
- Pu-pu-pu, sa të bukur ishin!
- Ç'punime të përkryera!
- Ç'damask! Ç'llustër!
- Apo nuk bënëin edhe punën e krevatit! Lëre, lëre!

Disa thoshnin se do të delnin me bollëk, të tjerë se ishin me pakicë. Sidoqoftë, të interesuarit, kur morën këtë lajm, u vunë në lëvizje. Në çast, dera e mobilerisë, krahas orarit të punës, u stolis edhe me një listë të gjatë me emrat e blerësve. Falë shkathtësisë, emri im zuri numrin rendor një, duke u bërë kështu për të gjithë të interesuarit një objekt zilie. Të pranishmit i hidhnin vështrime lak- mitare emrit tim dhe psherëtinin:

- Ky po, ky e ka të siguruar!
- Sikur edhe një divan i vetëm të dalë, ky e ka të sigurt.

Ata flisnin dhe mua se si më dukej. Sikur nuk e kisha regjistruar emrin për një divan e aq, po për ndonjë shëtitje turistike në Hënë. I kënaqur sa s'bëhet me shkathëtesinë time, fluturova drejt e në shtëpi.

- Përqaqomë, Fato e dashur! — i thirra sime shoqe-

je sapo hapa derën e apartamentit. — Emri i bashkëshortit tënd kryeson listën!


— Duhet të kesh parasysh, — ma preu hovin ajo — se ajo listë është e vlefshme gjer në mesnatë, prandaj tregohu vigjilent!

U mundova t'ia kundërshtoja këtë mendim, por s'qe e thënë një gjë e tillë. Pas një debati të gjatë e të zjarrtë, vendosëm që, në ora dy pas mesnate, unë të merrja shërbimin tek dera e mobilerisë.

Pikërisht në këtë orë, zilja e orës tingëlloi kërcënueshëm dhe unë, me sytë të kërcyer, u gjeta në këmbë, i gatshëm për shërbim. Gjatë rrugës mendoja si do ta gdhija atë natë në vetëmi të plotë dhe me këto mendime iu afrova dyqanit të mobilerisë, ku sa s'më ngriu gjaku! Para dyqanit, te dera, pashë ca hije që po lëviznin. Në ato çaste provova dy ndjenja të kundërta: gëzimin dhe keqardhjen. Gëzimin, sepse do të kisha me cilin të këmbeja dy para muhabet; keqardhjen sepse emri im nuk do të kryesonte më listën. Përhëndeta dhe iu afrova listës. Emri im, pa fijen e respektit, ishte zhdukur pa lënë gjurmë. U hodha një vështrim pyetës atyre të katërve, kur se nga bubulloi një zë:

— Nuk e dije zotrote se bashkë me ndërrimin e datës ndërron edhe radha?

E vështrova mirë atë që foli. Syri im prej magazinieri veteran pa se kisha të bëja me një kolos, që i kalonte të njëqind kilogramët, kështuqë nuk ia vlente barra qiranë të gërmoja më thellë. Gjene mirë, përsëri nuk isha i humbur. Shkrova emrin tim në numrin rendor pesë dhe fillova të përtypja ca gështenja të pjekura, të cilat m'i pat futur në xhep Fatoja qysh në darkë. Ndërkaq, një nga një erdhën dhe ca të tjerë e kështu na përshëndeti mën-gjesi. Fatmirësisht qëlloi ditë e diel dhe, ta merr mendja, asnjë nuk lëvizi nga vendi. Pas pak erdhi edhe shitësja.



— Me keqardhje ju njoftoj se divanët nuk dalin sot në shitje — na tha qysh te dëra.

— Po sikur të shiten? — pyeti kolosi.

— Ju siguroj që jo. Le që do të ketë me bollëk, prandaj mos e mundoni veten kot.

Megjithëse fjalët e saj qenë shumë të sinqerta, asnjëri nga ne nuk i besoi. Asnjë s'e lëshoi vendin e zënë me aq sakrifica. Kur gjunjët e mi filluan të ndienin peshën e trupit, erdhi Fatoja të merrte «turnin». Vajta në shtëpi, hëngra mëngjesin, bëra një sy gjumë dhe... përsëri në vëndroje. Koha kalonte dhe divanët me të vërtetë s'po dukeshin. Duke u thyer dita, filluan të thyhen edhe shpresat tona. Afër mbrëmjes, buzëvarur e me forcë të shteruara, lamë pozicionet dhe u kthyem në shtëpi.

— Sonte duhet të dalësh më herët, që të fitosh pozitën e humbur! — më ngacmoi në sedër Fatoja ime.

Dhe unë s'ia bëra fjalën dy. Ta merrte vesh njëherë e mirë ime shoqe se , kur ishte puna, unë bëhesha copë për problemet familjare.

Atë natë rashë të flija herët. Fatoja, me qëllim që të mos e zinte gjumi, mori të lante ca rroba, gjersa të vinte koha të më zgjonte mua. Ç'gjumë të sëkëlldisur që bëra atë natë! Ç'ëndrra të llahtarshme që pashë! Në njërin nga ato unë u ndodha në mes të një mizërie divanësh, por, do ti, sapo zgjatja dorën të zija njërin syresh, të gjithë sa ishin ia jepnin vrapit e më largoheshin. Por edhe unë, ama, s'u dorëzova. Fillova të vrapoj, aq sa më mbuluan djersët dhe, më në fund, arrita të bëja zap njërin, kur ndjeva një si lëkundje.

— Çohu, i dashur, çohu — më solli në vete zëri përkëdhelës i sime shoqeje.

Pashë orën. Duheshin edhe pesë minuta që akrepi i madh të pushtonte akrepin e vogël, që qëndronte tek dy mbëdhjeta. Gjeta shpejt e shpejt një letër, shkrova emrin

tim në krye, mora edhe një shishe me zamkë dhe u sula drejt mobilerisë. Merreni me mend zhgënjimin tim kur arrita atje dhe gjeta një grumbull njerëzish. Gjithë nerva e bëra letrën shuk dhe përshëndeta:

— Mirëmbërëma!

Asnjëri nuk ma ktheu përshëndetjen. Atëherë vura re se të gjithë ishin të preokupuar. Një plakë ishte ulur në një stol, kishte mbështjellur këmbët me batanije dhe po punonte me grep. Afër saj, i pështetur pas pervazit të vitrinës, një tjetër, me sa dukej llogaritar, se ç'jepte e merrte me ca bordero. Një djalosh vinte e vinte sa andej-këndej duke folur me vete. Në fillim thashë se kisha të bëja me ndonjë noksan, por pastaj mendova se do të ishte ndonjë student që po përgatitej për provimet e ardhshme. Të gjitha këto i shoqëronte gërhitja ritmike e një plaku, i cili ishte bërë sa një gogël dushku nën këmbët e llogaritarrit. Më takonte vendi i tetë! Ndërkohë m'u afrua djaloshi që fliste me vete.

— Më falni, — më tha — mos jeni gjë e zënë?

Unë, që deri në atë kohë po jepja e merrja të numëroja yjet, mblodha supet.

— A ka mundësi të më ndihmoni? — vazhdoi ai.

— Me gjithë qef! — ia ktheva i gëzuar, ngaqë do të merresha edhe unë me një punë. — Ç'duhet të bëj?

— Unë jam artist! — më zgjati dorën gjithë mirësjellje ai.

— Gëzohem shumë. Kurse unë magazinier! — i thashë:

— Që thua ti, në shfaqjen e ardhshme më kanë ngarkuar rolin e një punonjësi që është arrogant me vartësit, ndërsa servil me eprorët. Mundësisht, për pak minuta, bëju ti partneri im. Unë do të bërtas e do të çirrem, kurse ti do të përsëritësh vazhdimisht fjalën «si urdhëron».

— Si urdhëron! — i thashë.

— Do të vazhdojmë deri në skenën kur duhet të ndër-

hyjë drejtori, meqë s'kemi dublant tjetër. Dakord?

Unë pohova me kokë. Atëherë artisti u krekos e shtrembëroi fytyrën, sa më futi lemerinë, dhe thirri:

— S'ke turp!

— Si urdhëron — pëshpërita dhe u mblodha kruspull.

— E di se ç'të bëj unë? — e ngriti zërin artisti.

Zëri i tij kumbues e detyroi të kërcente përpjetë plakun që gërhiste.

— Mosni, more djema, mosni kështu! Për një radhë po shaheni e po grindeni? — na u drejtua.

— Paraqitu këtu shpejt! — vazhdoi artisti në drejtim tim, duke mos u vënë veshin fjalëve të plakut.

— Si urdhëron!

— Të mos përsëritet më asnjë rast i tillë! — e ngriti zërin në kupë të qiellit artisti këtë herë.

Mbi kokat tona kërciti një dritare dhe pastaj u dëgjua një zë:

— More, jeni në vete ju, apo jo? Na lini ore rehat të flemë!

Artisti, si të ishte i montuar mbi dy kushineta, bëri një rrotullim njëqintetëdhjetë gradësh andej nga erdhi zëri dhe, si bëri një përkulje të thellë, belbëzoi:

— Me fa... fa... falni, shoku drejtor...

Fill pas kësaj fjalie, artisti doli nga roli. dhe iu drejtua atij që foli nga dritarja:

— Ju falemnderit shumë, i dashur. Ka qenë e shkëlqyer! Keni hyrë në çastin e duhur në rolin e drejtorit! E keni dubluar në mënyrë të shkëlqyer!

Ai në dritare u step për një copë herë e pastaj tha si me vete:

— S'merret vesh këtu... Ose unë jam në ëndërr, ose ky që flet nuk është në terezi — dhe, duke thënë këto fjalë mbylli dritaren.

Artisti më falenderoi për ndihmën që i dhashë. Unë, që tashmë nuk kisha me se të merresha, fillova nga e para numërimin e yjeve që mbushnin kupën e qiellit. Kështu më gjeti mengjesi i ditës së dytë. Ime shoqe më solli mëngjesin dhe u nis për në punë.

— Si do të veprojmë tani? — pyeta të pranishmit, kur vura re se orari i punës kishte kaluar goxha.

— Unë nuk lëviz prej këndeje — tha llogaritari. — Punën që kisha për të kryer sot, e kreuva mbrëmë.

— Unë, fatmirësisht, jam në muajin e punës prodhuese! — shtoi një tjetër.

— Kurse unë e filloj punën në ora nëntë, kështu që kam edhe ca kohë — e vulosi artisti.

Plaka që punonte me grep dhe plaku që gërhiste qëlluan pensionistë, një tjetër ishte me raport mjekësor, nja dy a tre u shprehën se do ta sakrifikonin atë ditë pune, e kështu me radhë. Unë nuk mund të gjeja asnjë rrugëdalje. Magazina duhej hapur pa një, pa dy, pasi punëtorët prisnin furnizimin. Dhe ashtu bëra...

...Pas nja dy orësh thashë të dilja të shikoja ç'bëhej andej nga mobileria. Prej së largu më kapën sytë llogaritarin, i cili kishte vënë një alamet divani mbi shpatullat e tij të brishta dhe ecte si i dehur nga pesha e tij.

«Paskan dalë!» mendova, dhe ia dhashë një vrap të mirë. Sakaq u ndodha në mobileri. Plaka ishte kapardisur mbi një divan dhe vazhdonte punën e saj me grep. Me sa dukej priste nipat e mbesat që të vinin ta transportonin. Pak më tej pashë artistin, që edhe ai po i gëzohej divanit të sapoblerë. Iu afrova dhe fillova të sodis divanin e tij.

— Si lum ju! — i thashë — Unë mbeta pa gjë.

— Merr edhe ti. Ja tek i ke! — ma ktheu ai dhe zgjati dorën pas shpatullave të mia.

U ktheva dhe vura re disa divanë rresht. Mendova se ata do të ishin të zënë dhe tunda kokën.

— Ç'më tund kokën? — tha artisti — Ik e merre një-rin!

Lëviza nga vendi dhe iu afrova shitëses.

— Shoqe, i keni të zënë ata divanë? — e pyeta.

— Jo, mund të zgjidhni cilin të doni — ma ktheu buzagaz ajo.

Unë u sula i gëzuar drejt divanëve kur në derë u dha ime shoqe, Fatoja.

— Hë, Selo, more gjë? — pyeti që te dera.

— Urdhëro e zgjidh, grua e dashur! — i thashë tërë solemnitet dhe i tregova vargun e divanëve.

Ajo u hutua një copë herë, duke më vështruar herë mua, herë divanët e herë shitësen.

— Po si kështu? — erdhi në vete pastaj.

— Ç't'i bësh! Forca e zakonit! — tha përsëri buzagaz shitësja. — Unë ju thashë se do të ketë me bollëk, por ju nuk më besuat.

Fatoja u afrua dhe zgjodhëm njërin nga divanët. Pastaj i vura shpatullat dhe, me këmbët që më koloviteshin nga pagjumësia e dy netëve, iu drejtua shtëpisë.

FASULET

E

MAQOS

Unë po punoja në zyrë, kur dikush më njoftoi se më kërkonte kryetari.

— Mirëmëngjesi, shoku kryetar! — e përshëndeta sapo hapa derën e zyrës së tij. — Si u gdhitë, mirë?

— Unë mirë u gdhiva, mirë, po misri dhe fasulet nuk u gdhinë mirë hiç! — ma ktheu i nervozuar e pastaj shtoi: — Si është puna e asaj makinës sonë, xhanëm? Ka ndër mend të lëvizë nga vendi apo jo? Se edhe një shi si ai i mbrëmëshmi të na e zërë bukën në fushë, dhe na rroftë mundi e djersa e një viti të tërë pastaj! Dhe e gjithë kjo përse? Sepse makina jonë po bën javën që rri e shullohet në diell dhe asnjë s'e çan kokën për të!

E pashë që kryetari kishte marrë zjarr dhe se, me të drejtë, po shkarkohej mbi mua, që, përveç detyrës së furnitorit kryeja edhe atë të përgjegjësit të transportit të kooperativës.

— Si të them... — u përtypa unë.

— Asgjë mos më thuaj, asnjë justifikim! Por s'ke faj ti, jo! Fajin e kam unë, që nuk dhashë urdhër që misri të transportohej me kuaj.

— Po kuajt dhe makinën tjetër i kemi në mal, për transportimin e patateve, shoku kryetar, harruat?

— Me krahë, fundja! Pa hë, më thuaj tani, ka ndër mend të lëvizë nga vendi ajo makinë, apo jo?



Unë mblodha supet e s'dija ç't'i thosha se, që thoni ju, jam esëll nga puna e makinave.

— Ç'të të them, o shoku kryetar... Po t'i besojmë Ilmiut, shoferit të makinës, ai thotë se ajo duhet dërguar në ofiçinën qendrore për një riparim të përgjithshëm, pasi i paska rënë motori...

Kryetari më vështroi, tundi dorën dhe s'foli asnjë fjalë. Pastaj nxori paketën nga xhepi, më zgjati një cigare, e ndezi edhe një për vete e tha:

— Me demek, ti thua ta dërgojmë makinën në ofiçinë, kështu?

— Tani... po t'i besojmë Ilmiut...

— More, të mbeti goja: po t'i besojmë atij, po t'i besojmë këtij! E përse të mos i besojmë?

— Jo, ashtu kot — thashë unë, pasi në të vërtetë këto fjalë i kisha në majë të gjuhës vazhdimisht, edhe atëherë kur nuk kishin vend.

— Mos këput kumbulla të papjekura, dëgjon? Se po nuk u besuam njerëzve tanë të mirë, s'kemi gjë në torbë! — më tërhoqi vërejtjen. Domethënë makina ka nevojë për riparim të përgjithshëm, ë? — shtoi pastaj. — Mirë, more, e dërgojmë! — vendosi pas një heshtjeje të shkurtrë. Pa dale, dale! — iu kthye mendja. — Po sikur të na e vonojnë makinën, ç'të bëjmë, t'i biem curls?

— I bëjmë thirrje ndërmarrjes që na ka në patronazh të na japë një makinë për ca ditë dhe ata s'besoj të na e prishin.

— Të lumtë, Selim! — më rrahu shpatullat kryetari. — Ata na ngritën goxha mulli bloje, e jo më s'po na jepkan një makinë për pak ditë. Nisu menjëherë! — vendosi përfundimisht ai.

Unë arrita te dera, kur kryetari ma ktheu përsëri.

— Pa dale, dale! — më tha. — Po sikur ta merrnim në telefon atë ofiçinën e t'i blinim mendimin njëherë,

ç'thua — dhe, pa pritur miratimin tim, kapi dorezën e telefonit. — Alo... Jemi kooperativa bujqësore e Buzhanës... po... Dëshëm pak ofiçinën e riparimit të automjeteve, po... Veç pak shpejt, të lutem... Hë, më të lumtë! Alo, ofiçina? Jemi kooperativa bujqësore e Buzhanës. Si urdhëron. Kryetari i kooperativës jam. Po ju? Shefi i ofiçinës? Tungjatjeta, shoku shef! Kemi një makinë për riparim të përgjithshëm... Urdhëro? Me prodhimet? Mirë jemi, mirë, bile shumë mirë. Edhe fasulet det i kemi, të uruarat! E po, është e ushqyeshme, o shef, s'ke ç'i thua... Po, një makinë... Ehe.. ashtu? Po, po... falemnderit shumë e ta paçim hua... Urdhëro? Po, po edhe kërkërmadhe kemi. Shëndet e të mira, shoku shef! — i dha fund bisedës telefonike kryetari dhe u kthye nga unë: — Mori fund kjo punë. Gjej Ilmiun dhe nisu menjëherë. Shefi i ofiçinës më garantoj se brenda dhjetë ditëve makina do të jetë në këmbë si të ketë dalë nga fabrika!

Unë s'prita më. Dola furtunë nga zyra e kryetarit dhe vajta të thërrisja Ilmiun, i cili, gjatë ditëve që makina nuk punonte, kishte vajtur të ndihmonte në brigadën e ndërtuesve të kooperativës.

* * *

Udhëtuam afro gjashtë orë gjersa arritëm në qytet. Merreni me mend... atë udhë që më këmbë e bënim për katër orë, me makinën tonë e bëmë për gjashtë! Makinë i thënçin! Në vend që të na shpinte ajo në qytet, e shpëmë ne atë. Ia filluam me të shtyra që te zyrrat e kryesisë e po me të shtyra u futëm në qytet.

«Më tepër na hypi se i hypëm!» shfryja kur i vija supin për ta shtyrë.

Do të kishim mbetur në mes të udhës po të mos kishite qëlluar një traktor, i cili na rimorkjoi gjersa dolëm në rrugën e asfaltuar. Në qytet arritëm kur filloi të erret. E lamë makinën para portës kryesore të ofiçinës dhe vajtëm në hotel. Të nesërmen në mëngjes u drejtuam për në ofiçinë.

— Mirëmëngjesi, shok! — përshëndetëm një plak, që na doli përpara, sapo kaluam portën.

— Mirë se vini! — na e ktheu ai. — Çfarë ka e sëmura? — shtoi duke na treguar me gisht makinën.

— I ka rënë stomaku, xhaxho! — ia ktheu Ilmiu me shaka, — Kërkon një operim të vështirë, me sa duket!

— Sado i vështirë që të jetë operacioni, këta doktorët tani ia dalin në krye për bukuri! — u mburr plaku. — Ja ku po vijmë.

Ne u kthyem andej nga zgjati dorën ai dhe pamë se nga porta u futën disa djem e vajza.

— Mirëmëngjes, usta! — e përshëndetën.

— Mirëmëngjes, kryedoktor!

— Thomai erdhi?

— Tani e prishe! Sikur nuk e njeh ti atë! Ai të vijë në orar ku ma gjen, e jo me një çerek ore përpara!

Tjetri tundi dorën i pakënaqur dhe u largua me të shpejtë.

— Brigadieri ky! — na tha xha Myrtoja duke bërë me kokë nga i riu. — Agim e quajnë. Djalë për kokë të djalit!

Tha këta fjalë dhe nxori kutinë e duhanit për të dredhur një cigare.

— Shefi i ofiçinës nuk ka ardhur? — e pyeta.

— Shefi the? — qeshi Myrtoja. — Për të më pyeti edhe Agimi, po e ka me përtim mëngjesin Thomai. Sa e sa herë ia kanë shkukur veshët kolektivi e drejtoria, po pse, merr vesh koka e tij? Priteni në bufe, se një të ardhur andej merr hov ai.

U drejtuam për nga bufeja e oficinës dhe porositem nga një kafe. Sapo na erdhi porosia, në derë u dhanë dy veta. I pari na bëri shumë përshtypje. Vinte i shkurtër dhe i shëndoshë. I shëndoshë jashtë mase. Mezi ecte. Këmbët e tij, si për çudi, ishin të shkurtra e të holla, në kontrast me tërë atë trup të rrumbullakosur, sa s'dije të përcaktoje se ku e kishte belin. Duke parë atë njeri, bëra çudi me veten time se si mund të qëndronte ai kuinal tul (me siguri peshonte mbi njëqind kilogram), mbi ato këmbë të holla si kërthija.

— Hajde vozë, hajde! — ia bëri duke fishkëllyer Ilmiu.

Unë qesha. Ishte një nofkë më se e goditur. Trupi i tij i ngjiste me të vërtetë një voze që rrokulliset.

Tjetri ishte e kundërta e tij. Vinte i gjatë dhe i hollë, shumë i hollë, Mbi qafën e tij si të lejlekut, qëndronte një kokë në përmasa mbi mesataren. Tek pashë atë kokë të ngulur në mes dy supeve, mendja më vajti menjëherë te dordolecat që vinin dikur nëpër kopshte për të trembur sorrat. Në dorë mbante një trastë të rëndë, pesha e së cilës e shtëlliste së tepërmi.

— Usta, dy kafe e dy dopjo fërnat! — thirri qafëlejeku, që te dera.

U ulën në një tavolinë pranë nesh dhe ia filluan muhabetit kokë më kokë. Një muhabeti gjithë të qeshura e të pëshpëritura. Gotat e fërnatit nuk u vunë fare mbi tavolinë, por i rrëmbyen nga dora e bufetierit dhe i zbrazën në gojë menjëherë.

— Edhe dy dopjo të tjera, usta! — përsëriti qafëlejeku.

«Voza» sikur u revoltua nga porosia e tjetrit dhe u shpreh: «Po ta kisha ditur kështu, asqë do të futesha në bufe!» Sidoqoftë, edhe gotën e dytë ia rrëmbeu nga dora bufetierit dhe e rrëkëlleu me një frymë.

— Ah! — ia bëri duke kërcitur gjuhën gjithë kënaqësi. — Ilaç e shkuar ilaçit është ky fërnet i bekuar!

Pastaj u ngritën. Qafëlejleku pagoi e, ndërsa po dilnin, i tha tjetrit:

— Po këtë? — dhe i tregoi trastën që mbante në dorë.

— Lëre atje ku të thashë, se vete e marr më vonë. — ia ktheu «voza». — Sa bëjnë? — pyeti pastaj dhe dëshi të fuste dorën në xhep.

— Bah! Llaf është ky? Po ta dija kështu, nuk do t'i sillja fare! — sikur i mbeti qefi qafëlejlekut.

— More Jani, po...

— Po që ashtu, më mirë po i marr prapë...

— Mirë, mirë, nuk po ta prish, veç mos u zemëro! — i rrahu shpatullat «voza» dhe, si i futi krahun, kapërcyen pragun e derës së bufesë.

* * *

Qëndruam një copë herë të mirë në bufe e pastaj vajtëm përsëri te xha Myrtoja.

— Hë, e takuat? — na pyeti.

— Pse, erdhi?

— Nuk e patë atë të shëndoshin që hyri në bufe bashkë me një tjetër?

— Ai ishte? — i thashë unë.

— Dora vetë. Shkojini në zyrë, se sapo u fut.

I thashë Ilmiut të më priste aty, ndërsa unë u drejtova për nga zyrat. Mbi një derë lexova «SHEFI I OFIÇINËS». Në derë më përshëndeti një orar pritjeje mikroskopik.

«Me ç'duket, nuk paskam gjë në torbë me këtë shef, jo!» mendova dhe trokita.

Nga brenda u dëgjua një zë i gërvishtur, që s'u muar vesh se ç'tha, dhe unë shtyva derën. I buzëqesha me dashmirësi dhe u bëra gati ta përshëndesja, kur «voza» që rrinte pas një tavoline, m'u vërsul.

— More, dini apo nuk dini të lexoni ju, xhanëm? Nuk e shikoni në derë se në këtë kohë nuk kam orar pri-tjeje?

Unë stepa para këtij sulmi të befasishëm e megjithatë pata aq kurajo sa t'i thosha:

— Më falni, por...

— Më lër të qetë, se jam gjer në grykë me punë! — tha prerë «voza» dhe uli kokën mbi një regjistër.

Zëri i tij ishte për t'u admiruar. Ishte aq kumbues, sa mendova se mos erdhi nga ndonjë altoparlant i instaluar diku mureve të zyrës.

— Vij nga kooperativa bujqësore e Buzhanës — fillova unë, duke mos ua vënë veshin të bërtiturave të tij shembullore. — Sipas bisedës telefonike që ka bërë kryetari i kooperativës, solla makinën për riparim të përgjithshëm.

Fjalët e mia, megjithëse të thjeshta, bënë një reaktion të menjëhershëm në personin e «vozës». Ai ngriti kokën nga regjistri e më vështroi, ndërsa fytyra dalëngadalë filloi të stolisej me një buzëqeshje që mua më ngjalli shpresat.

— Aha, qenkeni ai shoku i fasules... desha të them i makinës — u gjallërua ai. — Gëzohem shumë që po njihemi nga afër. Mua më quajnë Thoma. Në konfidencë më thërrasin Maqo!

— E gëzofsh! — i thashë. — Kurse mua më quajnë Selim!

— Po, po, unë jam Thomai komplet, shefi i ofiçinës — u gjallërua më tej dhe më zgjati paketën e cigareve. — Pa hë, ç'kemi andej nga fshati? Me punë, mirë? Në

këtë stinë fshati është gjer në grykë me punë, se helbete...

— Punë sa të duash, shoku Thoma, prandaj edhe kjo puna e makinës...

— Do të preferoja të më thërrisnit shkurt, Maço. Nuk më pëlqejnë ceremonitë, numri shumë e ku ta di unë — tha ai me një thjeshtësi që më habiti.

Ai fliste, unë e vështroja. Ndryshe e mendova e ndryshe më doli ky person. Ai po më drejtohej me një thjeshtësi e me një ton të tillë, thua se njiheshim prej vitesh. Ndërsa ai fliste, vëreja se sytë i hidhte herë-herë nga duart e mia, që i kisha vënë prapa. Ai sikur kërkonte diçka që i kishte humbur.

— Kështu, domethënë, sollët makinën, ë?

— Po, e sollëm dhe na duhet një çikë si shpejt.

— Puna e makinës rregullohet, xhanëm, veçse... — u përtyp Thomai dhe, si vështroi edhe njëherë nga duart e mia, që vazhdoja t'i mbaja pas, tha: — Thonë se fasulja e Buzhanës është e përmendur, kështu? U gëzova shumë për prodhimet tuaja të mbara!

Ky Thomai po i kalonte të gjitha parashikimet. Jo vetëm që po na e rregullonte shpejt e shpejt makinën, por interesohej e gëzohej bashkë me ne për prodhimet tona, sikur të interesohej për ndonjë problem të vetin.

— Ashtu është, shoku Thoma...

— Mundësisht më thërrisni Maço — nguli këmbë përsëri ai, me një shprehje pakënaqësie në fytyrë.

— Si urdhëron, Maço — korrigjova vetveten unë. — Për punë të fasules kooperativa jonë është e përmendur.

— Ah, fshati, fshati! — psherëtiu thellë Maçoja, sikur po fliste për ndonjë planet tjetër shumë të dëshiruar. — Fshati i ajrit të pastër, i ujërave që gurgullojnë, i livadheve të blerta, fshati i të mirave materiale... Ah!...

Duke thënë këto fjalë ai i mbylli sytë përgjysmë.

— T'ju them të drejtën, fasulen e Buzhanës e preferojmë familjarisht — vazhdoi Thomai duke u kapur përsëri pas fasules sonë. — Ka shumë anë të mira: e ushqyesme, ekonomike e ku di unë çfarë tjetër. Fëmijët, në veçanti, çmenden pas saj. Ai i vogli, sapo futem në shtëpi, më hidhet në krahë e më thotë: «Babi, na solle fasule Buzhane?»

Thomai ishte një njohës i rrallë i fasules. Ai fliste dhe bënte ç'bënte mundahej të shikonte duart e mia, që i mbaja prapa. Unë isha pështetur pas murit të zyrës dhe, për çudi, s'm'u dha që s'm'u dha që t'i nxirra duart përpara.

— Po ti, more shoku Selim, nxirri duart përpara, pse rri ashtu i drojtur? — s'iu durua atij më në fund.

Unë i nxora duart dhe vura re se fytyra e Maqos filloi të transformohet. Nga e qeshur që ishte, dalëngadalë mori një hije të rëndë, sa më futi në dyshime. Vështrova duart e mia, duke menduar se mos ato e kishin fajin për sterrosjen e fytyrës së tij, por në to nuk dallova asgjë shqetësuese.

— Më vjen shumë keq. Po ta dija se i preferonit kaq shumë fasulet tona, do t'ju kisha sjellë nga shtëpia një të zier — i thashë sa për t'i hyrë në zemër.

— Bah! Ç'është ajo fjalë! — u shtrembërua në fytyrë ai. — Do të kishit bërë gabimin më të madh! Këtij i thonë shqeto ryshfet!

Ai i tha këto fjalë me një farë nervozizmi dhe me një hije të rëndë shtoi:

— Pa të hidhemi në çështje pune! Çfarë halli kishit?

— Solla makinën për riparim të përgjithshëm — i thashë.

— Ku e keni?

— Jashtë, te porta.

— Pa ta shohim njëherë.

Ai u ngrit nga karrigia dhe u nis drejt derës. Kur iu afrua makinës, e vështroi një copë herë duke tundur kokën me qortim e pastaj u kthye nga unë.

— Gjynah, e paskeni bërë sallatë fare! — tha, duke u nisur përsëri në drejtim të zyrës.

Unë bëra ta ndjek pas, kur më doli përpara Ilmiu!

— Hë? — më pyeti. — Si shkojnë punët?

— As unë nuk di ç'të them. Në fillim më priti me këmbët e para, pastaj gjithë përzemërsi, kurse tani nga fundi u çakordua fare! — i thashë dhe, duke e lënë atë të habitur, u drejtova përsëri për nga zyra e shefit.

— Hë, fillojmë? — tha me një zë të prerë.

Si hungëriti kështu, hapi sirtarin, nxori që andej një biçim formulari dhe gjithnjë nervoz, vazhdoi:

— Emri e mbiemri?

— Selim, Selim Kamberi.

— Qendra e punës?

— Kooperativa bujqësore e Buzhanës.

— Detyra që kryen atje?

— Furnitor dhe përgjegjës transporti.

Për një çast pasoi heshtje. Unë, i habitur nga gjithë kjo mori pyetjesh, vështroja Thomanë tek shkruante mbi formular.

— Emrin? — ngriti kokën Thomai.

— Urdhëro? — zgjata veshin drejt tij unë dhe vura dorën si hinkë në të.

— Emrin, thashë! — përsëriti nervoz Thomai.

— Po ta thashë njëherë, o Maço!

Ai përplasi penën, pastaj pëllëmbën dhe më vështroi mu në bebe të syrit.

— Mësoju të flasësh! Më quajnë Thoma e jo Maço! Dhe e dyta, po të pyes për emrin e makinës dhe jo tëndin!

— Emrin e makinës? — u stepa unë. — Po makinë me...

— Makina, po kemi disa lloje makinash! Kemi «Gaz», «Zis».

— Ehe! «Zis» e quajnë makinën tonë, «Zis»! — i thashë.

Shef Thomai i lëshonte pyetjet si breshër dhe shkruante mbi formular.

— Mosha? — vazhdoi më tej seria e pyetjeve.

— 1935!

— Dyzet e një vjet? — tha i habitur Thomai.

— Rrumbullak! — ia ktheva i sigurt.

— Dëgjo, shok, kërkon të tallesh me mua ti, apo si e ke hallin? — i kërceu damari shefit.

— As që më vete ndër mend një gjë e tillë — ia ktheva urtë e butë. — Pse, mos dukem gjë më i ri? Urdhëro e shiko pasaportën, po deshe — dhe, duke thënë këto fjalë, bëra të fus dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës.

Thomai përplasi me forcë shuplakën mbi tryezë. Si të kishte pritur këtë sinjal, dikush trokiti në derë. U dëgjua hapja e saj. Unë ktheva kokën anej dhe pashë kokën e qafëlejleku.

— Maqo, vajta ta lë atë porosinë atje ku më the, por nuk ishte ai shoku aty. Ta lë këtu, si thua? — e pyeti ai.

— Lëre, se ia shpie unë më vonë! — ia ktheu si i mërzitur shefi.

Qafëlejleku u fut në zyrë me trastën e rëndë në dorë, e vuri poshtë tryezës dhe, si i adresoi një buzëqeshje, i tha:

— Pas dhjetë ditësh, ë?

— Ik tani! U morëm vesh, më duket! — i tundi dorën Thomai dhe qafëlejleku u zhduk nga zyra. — Dëgjo ti! — m'u kthye mua pastaj. — Mua më duhet mosha e makinës dhe jo jotja, merr vesh?

Hajde, hajde! Ky shef ose do të kishte ndonjë dërrasë mangut ose do të ishte turbulluar nga fërnetet që kishte pirë. Më bëhej se gabimisht kisha hyrë në zyrën e gjendjes civile.

— Moshën e makinës?! — ia bëra i turbulluar.

— Pikërisht.

— More, më duket se paske ti nevojë për riparim të përgjithshëm, e jo makina! — S'durova dot më dhe shpërtheva unë, që shpërthej një herë në dhjetë vjet, aq i qetë jam. — Pse, more, t'u mbylltë, se mos i kam prerë kërthizën makinës unë?

— Dëgjo! Mos m'u çirr e mos më fyej ashtu, merr vesh? — u nxeh dhe ai. — Po e dite moshën e makinës, mirë, po nuk e dite, nisu nga ke ardhur!

E pashë se për hiçgjë mund të prishej puna, prandaj, nervave të mia të qeta u bëra thirrje të qetësoheshin edhe në këtë rast.

— Një minutë, sa të pyes shoferin — i thashë dhe dola.

Nuk isha në gjendje të kuptoja kthesën e menjëherëshme të këtij Thomait enigmatik. Ilmiun e gjeta në oborrin e ofiçinës, tek po bisedonte me qafëlejlekun.

— E, kur të tha të vish ta marrësh? — dëgjova Ilmiun tek e pyeti atë.

— Pas dhjetë ditësh me siguri! — tha qafëlejleku dhe u largua i gëzuar, duke fishkëllyer një melodi gazmore.

— Dëgjo — i thashë Ilmiut. — Di gjë ti ç'moshë ka makina jonë?

Kur dëgjoi këto fjalë nga goja ime, Ilmiu më vështroi tërë frikë. Pastaj, kur vuri re se unë nuk paraqisja ndonjë rrezikshmëri, ia plasi të qeshurit sa u tund oborri.

— Ç'moshë, more Selim, se na këpute brinjët? — tha gjithnjë duke qeshur.

— Mos qesh, por thuaje shpejt, se e kërkon shefi i ofiçinës! — i thashë.

— More, po paska qenë tuaf njeri ky shefi! — ndryshoi menjëherë Ilmiu. — E pe atë shoferin që e gjete duke biseduar me mua? I dha një trastë me portokalle dhe dy dopio fërnjet këtij shefit dhe e rregulloi punën për bukuri! Kurse ne na pyet se ç'moshë ka makina, dallkauku! Unë mbaj mend vetëm se makinën e kemi blerë të re fare në vitin 1962!

«More, more! — thashë me vete ndërsa po largohesha nga Ilmiu. — Me demek prandaj qenka interesuar kaq shumë për fasulet tona ky. Prandaj paska ndryshuar në fytyrë kur pa duart e mia, sepse i paskam pasur bosh!»

Me këto mendime, pa trokitur fare, shtyva derën e zyrës dhe u futa brenda. Ai, ndërkohë, po qëronte një kokër portokall. I ngula sytë te trasta që ndodhej mbi tavolinë. Më erdhi t'i merrja ato portokalle e t'ia vërvisja në kokë një nga një. Unë bëra të hapja gojën t'i flisja, por ndërkohë dera e zyrës u hap.

Hyri një djalë rreth dymbëdhjetë vjeç, me një shkop në dorë.

— Puçi, Puçi! — i thirri Thomai.

— Urdhëro — tha, i biri.

Thomai u përkul dhe me vështirësi nxori trastën që poshtë tryezës.

— Merre këtë trastë e çoje në shtëpi. Veç mos e trazo, se është e tjetër kujt.

— Posi, e tjetër kujt! Kështu the edhe atë ditë për atë vajin e ullirit që të solli ai shoferi nga Himara, por...

— Ik tani, se kemi punë! — hungëroi Thomai duke i vënë trastën mbi kurriz të birit.

Puçi, i kërrusur nga pesha e trastës, u largua. E pashë se po më fluturonte zogu nga dora, prandaj dola fill pas tij. Nga pas dëgjova zërin e Thomait tek më thirri,

por nuk ia vura veshin. Vendosa t'ia nxirrja të palarat në shesh. Kur dola në oborr, pashë Puçin, i cili kishte rrëmbyer një gur në dorë dhe po i kërcënohej xha Myrtos.

— Pse m'i more portokallet, ë, pse m'i more? Do t'i them babit të të pushojë nga puna që nesër!

Plaku i mirë i fliste që të largohej, se portokallet do t'ia çonte drejtorit në zyrë, po kur pa se Puçi i tha fjalë të rënda, iu vërsul me vrap dhe djali u zhduk si era.

— Sa i keq! — tha xha Myrtoja — i biri i të jatit, s'ke ç'i thua! Sheh rrushi rrushin e piqet! Nuk vete në shkollë, po rri e më bredh rrugëve gjithë ditën!

Pastaj mori trastën dhe u drejtua nga zyrat. Nga kabina e xha Myrtos doli Ilmiu.

— Hë! tha. — Pandeh se e ka mallin e të jatit ai që livadhis ashtu?

— Ti i the xha Myrtos? — e pyeta.

— Ta merr mendja! Pse ta lija në heshtje?

Në hyrje të sallonit të zyrave bëri ballë trupi i majmur i Thomait. Sapo më pa mua, m'u drejtua:

— Ti, shok, fute makinën në ofiçinë dhe hajde pas tre muajsh!

Unë iu afrova dhe u bëra gati t'i shfryja, kur nga pas i foli xha Myrtoja:

— Shko se të kërkon drejtori!

Thomai e pa me përçmim plakun e pastaj mua dhe u nis për në zyrën e drejtorit.

* * *

Të mërzhitur sa s'bëhet, bashkë me Ilmiun, u ulëm në një stol pranë kabinës së xha Myrtos. Xha Myrtoja qëndronte te dera e kabinës duke dredhur një cigare. Pra-

në nesh kaloi me nxitim Agimi, brigadieri për të cilin na foli në mëngjes xha Myrtoja:

— Hë, xha Myrto? — i thirri plakut.

— Këtë herë ra në çark, doktor!

— Me të dyja këmbët?

— Këtë herë s'ka nga të lëvizë fare! Shko, se te drejtori e ke.

Agimi bëri për nga zyrat.

— Turp, more djema, turp! — na u drejtua ne xha Myrtoja, — Na turpëroi të gjithëve, Ç't'i bësh? Në pyll, krahas drurëve të drejtë, rritet edhe ndonjë i shtrembër, Por dhe ne, ama, dimë t'i shkullim që nga rrënjët! More, e njihni ju atë që solli trastën me portokalle? — na pyeti pastaj.

— Tani edhe pak e do të vijë të sjellë makinën këtu — tha Ilmiu.

Xha Myrtoja tundi kokën dhe u fut brenda në kabinë. Kishte kaluar koha e drekës dhe fillova të ndiej trazimet e stomakut.

— Vemi hamë drekë? — i thashë Ilmiut.

U ngritëm dhe u nisëm drejt mensës së ofiçinës. Nuk kishte shumë njerëz. U ulëm dhe kamarieri s'vonoi të vijë.

— Urdhëroni? — na tha.

Porositëm tre tava kosi. Menca, dalëngadalë filloi të mbushet. Në tavolinën ku ishim ne erdhi u ul Agimi.

— Nga ju kemi? — hyri në bisedë ai.

— Nga Buzhana — i thashë. — Ti, brigadier je këtu?

Ai pohoi me një të tundur të kokës.

— Sollëm makinën për riparim, që thua ti, por na hasi sharra në gozhdë. — tha Ilmiu. — Paskeni një shef këtu, që i pëlqekan shumë portokallet e fasulet!

— Pse, mos i sollët gjë fasule ju? — ngriti kokën ai.

— Pse, ç'u bëmë ne, shokët e atij qafëlejlekut që so-

lli trastën me portokalle? — u prek Ilmiu. — U lëpi mjaft ky shefi juaj, dhe e pa që nuk i doli gjë, na tha të vinim pas tre muajsh ta merrnim makinën, kurse atij qafëlejleku me portokalle i tha të vinte pas dhjetë ditësh!

Sa mbaroi këto fjalë Ilmiu, në derën e mensës u dha qafëlejleku.

— Fol për qenin, rrëmbe shkopin! — thashë. — Ja ku e keni!

Qafëlejleku na dalloj dhe u drejtua nga tavolina jonë.

— Ju bëftë mirë! Ti je brigadieri? — iu drejtua Agimit.

— Unë. Deshe gjë?

— Të kërkova një copë herë, por nuk të gjeta. Urdhëro këtë letër nga shoku Thoma! — tha dhe i zgjati një letër.

Agimi e mori, i hodhi një sy dhe e bëri copë-copë.

— Si guxon?! — thirri qafëlejleku. — Do të anko hem tek shoku Thoma!

— I mjeri ti! — i tha duke i hedhur një vështrim përçmues Agimi. — Më vjen keq për ato portokallet e për fërnjetet që të vajtën dëm!

Qafëlejleku shtangu nga këto fjalë. Pranë nesh u afrua xha Myrtoja, seç i tha qafëlejleku dhe, si na shkeli syrin gjithë shejtanllëk, doli bashkë me të. Mbaruam së ngrëni dhe dolëm edhe ne.

— Ku e keni makinën? — tha Agimi.

— Këtu, te porta.

— Futeni brenda dhe hajdeni nga java tjetër. Mbase e bëjmë gati.

I shtrënguam dorën fort dhe të gëzuar sa s'bëhet dolëm nga porta kryesore e ofiçinës. Futëm makinën brenda dhe vajtëm të bisedonim me drejtorin e ndërmarrjes që ka në patronazh kooperativat tona bujqësore, që të na jepnin një makinë për pak ditë.

Për një javë rresht punuam ditë e natë. Transportonim me makinë, qerre, kuaj... Më shumë se gjysmën e misrit, të fasules dhe të patateve, që ishin lart në mal, i transportuam.

Në krye të javës unë dhe Ilmiu u nisëm përsëri për në qytet, duke shpresuar se makinën do ta gjenim të rregulluar. Morëm me vete edhe një kuintal fasule dhe e hodhëm në karrocerinë e makinës që na dha ndërmarra që na ka në patronazh. Arritëm shpejt në qytet. Xha Myrtoja, kur pa se nga makina hodhëm një goxha thes me fasule, vuri duart në kokë.

— More, jeni në vete ju, apo u çmëndët? — thirri.
— Nuk e morët vesh se ç'hoqën Thomai me atë qafëlejekun për këto punë? Do të njoftoj drejtorin menjëherë!
— na tundi grushtin dhe vrapoi andej nga zyrat.

Unë qesha, lashë Ilmiun me thesin e fasuleve te porta dhe vajta në oficinë të takoj Agimin. Vështrova në të gjitha anët, por nuk ma zuri syri gjëkund.

— Urdhëroni, kërkoni njeri? — na u afrua një i ri i panjohur me rroba të ndotura gjithë vaj e graso.

— Dëshëm brigadierin.

— Unë jam brigadieri — ma ktheu ai.

Diç më theri në zemër. Mos vallë Agimin e kishin shkarkuar nga detyra e brigadierit? Ku ta dish, ndofta edhe ai kishte qenë i mpleksur me Thomanë... Po na ecte tërs me makinën.

— Po ai... Agimi? — i thashë

— Ai nuk është më brigadier — tha buzagaz djaloshi.

— Domethënë, makina jonë...

— Ç'targë e keni?

— BD 99-99 — i thashë.

— Ja tek e keni!

Hodha sytë andej nga zgjati dorën ai dhe stepa. Para meje ishin rreshtuar disa makina që flakëronin nën rrezet e diellit të asaj dite vjeshte. Mes tyre ishte edhe makina jonë. E njoha vetëm nga targa. S'kishte mbetur asnjë shenjë tjetër nga makina që patëm dorëzuar para një jave. Një rreze e fortë dielli i binte mbi xhamin e përparmë të kabinës dhe reflektimi i saj më vrau sytë.

— Hë, si të duket? — tha brigadieri i ri.

— Si nuse me tela! — i thashë i kënaqur sa s'bëhet.

— Kaloni andej nga shefi i oficinës, bëni formalitetet dhe mund ta merrni që sot — tha brigadieri dhe u largua.

Përsëri do të kisha punë me atë Thomanë! Nuk mund ta shihja dot me sy. Le që kushedi ç'formularë do të fillonte të plotësonte, kurse ne nuk na priste puna! «Po vete — i dhashë karar. — Me këtë sebeb i këmbëj edhe dy llafe më të!»

Mbi derën e zyrës së shefit nuk kishte më orar pritjeje. Trokita, hapa derën, dhe... Merreni me mend habinë time, kur, në vend të «vozës» pas tavolinës, dallova Agimin!

— Urdhëroni! — u ngrit nga vendi ai dhe më zgjati dorën.

— Po ti këtu?! — i thashë.

— Ja, ç't'i bësh? Në vend të hekurave, tani duhet të merrem me shkresurina! — u ankua ai.

— Po Thomai?

— Në prodhim. Ia futi këmbët në një këpucë kolektivi.

Jashtë, në oborr, vlonte zhurma e punës, së shpejtë e të gëzuar.

ZINXHIRI...

Nikollaj Sokollojevi, hetues i policisë qëndrore të Moskës, ngriti receptorin e telefonit dhe urdhëroi:

— Më sillni menjëherë qytetaren së cilës iu gjet narotiku sot në mëngjes!

Si lëshoi këtë urdhër të prerë, vendosi duart mbi tryezën e punës dhe ndenji në pritje. Kaluan disa minuta, por atë nuk po ia sillnin ende. Kur zgjati dorën të ngrinte për së dyti receptorin, dera e zyrës trokiti fort.

— Hyrë! — thirri Sokollojevi i nervozuar.


Dera u hap dhe në prag të saj u paraqit një milic.

— Tavarish naçalnik, sipas urdhrit tuaj...

Sokollojevi tundi dorën i bezdisur dhe sakaq në zyrë u fut një vajzë e re, veshur sipas modës së fundit. Milici nderoi dhe mbylli derën. Hetuesi u mundua të dallonte fytyrën e të porsaardhurës, por nuk ia doli mbanë. Flokët e gjatë, që i vareshin supeve, ia kishin mbuluar thuasje plotësisht atë.

— Uluni, qytetare! — e ftoi me një farë delikatese Sokollojevi.

Ajo u kapardis këmbë mbi këmbë në kolltukun pranë, zgjati dorën dhe mori një cigare në paketën e hapur që ndodhej mbi tryezë, e ndezi me çakmakun që nxori nga çanta e saj dhe ndenji në pritje. Në qëndrimin dhe sjelljen e saj kishte diçka që i tërhoqën vëmendjen dhe që i pëlqyen Sokollojevit. «Sidoqoftë, tani të fillojmë nga pyetjet. Të tjerat i shohim më vonë» mendoi tek vështronte ngultas femrën simpatike e pastaj iu drejtua asaj:



— Emri juaj, qytetare?

— Ljuba, Ljuba Aleksejevna!

— Aleksejevna?! — u habit ai dhe heshti për një çast. Ajo u dha flokëve me dorë dhe Sokollojevit iu duk se diku e kishte parë atë fytyrë. — Më falni, atësia?

— Aleksej Dmitriç.

— Aleksej Dmitriç! — u ngrit në këmbë me rrëmbim Sokollojevi. — Mos e keni fjalën për majorin...

— Pikërisht! — ia ktheu gjithnjë e qetë Aleksejevna.

Sokollojevi bëri dy hapa dhe iu afrua dritares. Domethënë kjo na qenka vajza e majorit Aleksej Dmitriç, punonjësit të policisë kriminale!... Mos vallë kjo donte të thoshte që të ndërpriste hetimet dhe t'i vinte kryq kësaj çështjeje? Jo, jo, sidoqoftë ajo duhej ta kishte marrë nga dikush atë narkotik. Dhe ky dikush duhej zbuluar patjetër.

— Qytetare Aleksejevna! — u kthye i vendosur drejt saj Sokollojevi. — Sot në mëngjes, agjentët tanë kanë gjetur në çantën tuaj këtë sasi narkotiku. — Duke thënë këto fjalë, hapi sirtarin, nxori që andej një kuti dhe e vuri mbi tryezë. — Mund të na thoni kush jua dha?

Në vend të përgjigjes Aleksejevna shfryu fort dhe lëshoi një fjollë të dendur tymi.

— Më thoni ku e morët dhe ju do të jeni e lirë — përsëriti Sokollojevi.

Aleksejevna vazhdonte të heshte. Thithte cigaren me etje të madhe dhe e lëshonte tymin rrathë-rrathë nëpër hapësirën e zyrës.

— Mos më detyroni të njoftoj atin tuaj, Aleksejevna! — vazhdoi Sokollojevi.

— Si t'ju them... — e hapi gojën më në fund ajo. — Mbrëmë e kalova natën me një djalë, dhe ai...

— Si e quanin atë djalë? Ku banon? — pyeti shpejt e shpejt Sokollojevi duke nxjerrë stilografin.

— Kur u ndamë pas mesit të natës, ai më la adresën e tij — tha Aleksejevna e ndërkohë nxori një bllok të vogël nga çanta. — E quanin Grisha... Rruga «Gorki»... 17, 123.

Sokollojevi shtangu. Stilografi që mbante shtrënguar në dorë i shpëtoi dhe u përplas mbi tryezë.

— Grisha?! — mezi belbëzoi — «Gorki»... 17... 123...?! Jeni e sigurt, qytetare Aleksejevna?

— Plotësisht e sigurt — tundi kokën ajo.

Hetuesi Sokollojev filloi të lëvizë nervoz nëpër zyrë. Dy herë iu afrua telefonit, por të dy herët u tërhoq prej tij, sikur receptori të kishte marrë flakë. Mos ishte ndonjë ngatërresë?... Megjithatë... Adresa ishte pikërisht ajo... mbiemri gjithashtu... Por jo, jo! Nuk kishte se si të ngjiste një gjë e tillë. Me siguri që huligani, i cili kishte kaluar natën me këtë vajzë të shturur, e kishte mashtruar duke i dhënë një emër dhe adresë të rreme...

Si arriti në këtë përfundim, hetuesi Sokollojev buzëqeshi disi i lehtësuar. Ai bëri të ulej në vendin e tij të punës kur dera u hap me forcë dhe në zyrë u fut një djalë i ri.

— Hello, baba! — iu drejtua Sokollojevit. — Më jep menjëherë pesëdhjetë rubla!

— Grisha! — belbëzoi lehtë Aleksejevna.

— Ljuba! — u kthye nga ajo djaloshi. — Ljubočka ime e shtrenjtë! — shtoi pastaj dhe deshi të vraponte drejt saj.

— Grisha! — i tërhoqi vëmendjen Sokollojevi të birit e pastaj iu drejtua Aleksejevnës: — Jeni e lirë qytetare, mund të shkoni!

— Falemnderit, tavarish hetues! Dasvidania! — i tundi dorën ajo dhe, si i hodhi një vështrim Grishës, doli duke u tundur.

Atë e bir mbatën vetëm për vetëm dhe vështruan njëri-tjetrin.

— Ku e more narkotikun që i ke dhënë mbrëmë kësaj femre? — iu drejtua rreptë Sokollojevi.

— Pikërisht për këtë më duhen pesëdhjetë rublat. M'i jep shpejt, përndryshe Anatoli...

— Anatoli?! Ç'është ky Anatol? — ndërhyri i ati.

— Ai që i bleva këtë narkotik. M'i jep menjëherë pesëdhjetë rublat, përndryshe ai...

— Ku banon ai, në ç'adresë?

— Rruga «Vostok» 29,84 — ia ktheu Grisha. — Më jep shpejt rublat!

Në vend të përgjigjes, Sokollojevi ngriti receptorin e telefonit dhe se kujt i foli:

— Nisu menjëherë në rrugën «Vostok», 29,84 e më sillni këtu një farë Anatoli...

— Baba! — thirri Grisha.

— Rri i qetë. Unë dua të zbuloj vendburimin se nga ka hyrë kontrabandë ky narkotik! — u mundua ta qetësojë Sokollojevi.

— Po ai... — diçka desh të thoshte Grisha, por ndërkohë i ati doli që t'i raportonte shefit të tij se hetimet lidhur me narkotikun e gjetur në mëngjes po shkonin për bukuri...

* * *

Kur u kthye pas ndonjë ore në kabinetin e punës, Sokollojevi pa se në kolltukun e tij ishte kapardisur duke pirë duhan një djalë i ri me flokët që i arrinin gjer mbi supe. Sokollojevi u bë gati t'i fliste atij të pacipi, kur ai, gjithë ironi e pa lëvizur nga kolltuku, iu drejtua:

— Sipas urdhrit tuaj ju paraqitet qytetari Anatol!
Me se mund t'ju shërbej, daragoi?

Qëndrimi dhe toni i tij mospërfillës e tërbuan Sokollojevin. Mendoi t'i plotësonte menjëherë fletarrestin, por më parë vendosi ta merrte në pyetje.

— Ku e more këtë narkotik, huligan? — iu drejtua me zë të egër duke i treguar me sy kutinë që prehej mbi tryezë. — Po të tregosh të vërtetën do të kesh lehtësira.

Djali qeshi me të madhe e pastaj tha:

— Nuk kam asnjë arsye përse mos të tregoj. Ma solli im atë kur u kthye herën e fundit nga Tel-Avivi...

— Yt atë? Si quhet ai? — tha Sokollojevi dhe bëri gati stilografin. Hetimi po merrte fund. Kontrabandisti po dilte në shesh.

— Aleksandër Prokofiev! — tha djaloshi dhe qeshi përsëri me të madhe.

Këtë herë stilografi i Sokollojevit u lëshua mbi dysheme dhe u ngul pingul mbi parketin e lustrosur, ndërsa balli iu mbush menjëherë me bula djerse.

— Ale... Aleksandër Pro... Pro... ko... fiev?! — iu muar goja dhe fytyrën e tij e mbuloi ngërdheshja si t'i kishte dhënë kush ndonjë grusht të fortë turinjve. — Domethënë... ju jeni djali i të nderuarit e të respektuarit tonë të shumëdashur, Ale... Ale... ksandër Pro... kofievit, shefit tonë të nderuar?!... O perëndi!! — mbylli sytë pastaj dhe mekanikisht nxori shaminë të fshinte djersët që i venin çurg.

— Me se mund t'ju shërbej, daragoi? përsëriti djaloshi edhe më ironik.

— Më falni... ju kërkoj ndjesë... domethënë... I transmetoni të falat tona të përzemërta të nderuarit e të respektuarit tonë të dashur, Ale... Aleksandër Prokofievit, daragoi naçallnik Anatol...

Anatoli, i kënaqur e buzagaz doli nga zyra, i ndjekur

nga Sokollojevi i përkulur. Ai e përcolli gjer në fund të shkallëve e pastaj, duke iu marrë këmbët, u mbyll në zyrë.

«O perëndi! — mendoj. — Ç'zinxhir i ngatërruar!» dhe padashur dora i preku kutinë me narkotik, që ishte ende mbi tryezë. Mekanikisht e hapi atë, futi dorën e sakaq filloi të mbllaçisë...» O zot! — u kujtua pastaj. — Po unë harrova t'i jap rublat që i kishte borxh Grisha!»

Pa mbaruar këtë mendim u turr edhe një herë poshtë shkallëve për t'i dorëzuar Anatolit pesëdhjetë rublat...

BURRI MBI TIMON

Atë mëngjes, Pjetër Fjodoroviçi doli i gëzuar si asnjëherë tjetër nga fshati ku kishte lindur, ku kishte kaluar tërë ato vite të jetës së tij. Duke fishkëllyer një melodi gazmore, doli në rrugën e gjerë që të shpinte në Moskë. Makina e vetura nga markat më të ndryshme shkonin e vinin, por asnjëra prej tyre s'qëndroi. Pastaj filloi të ecte buzë rrugës së gjerë, i bindur se do të gjente ndonjë makinë që ta çonte gjer në Moskë.

Ishte i kënaqur dhe kjo shprehej në fytyrë, në ecje, në gjithshka. Çdo gjë i kishte vajtur si në vaj. Shtëpinë në fshat e kishte shitur me një çmim të arsyeshëm dhe rublat që kishte marrë nga shitja e saj preheshin në xhepin e brendshëm të xhaketës. E ndiente fryrjen e xhepit dhe kjo e guduliste në tërë qenien e tij. S'kishte pasur në xhep kurrë një shumë të tillë të majme. Vërtet që gjysma e atyre rublave do të futej në portofolin e atij nëpunësit të strehimit (si shpërblim për apartamentin që do t'i jepte menjëherë) por kjo nuk ishte kryesorja.

«Ç't'i bësh? — mendoi Fjodoroviçi. — Sot tek ne nuk mund të marrësh një gjë të vogël pa ryshfet, e jo më një apartament të tërë!»

E ç'rëndësi kishte kjo? Rëndësi kishte se, që prej kësaj dite, Fjodoroviçi nuk do të ishte më një fshatar e aq, por safi moskovit, me një apartament me dy dhoma e një kuzhinë. Kësaj i thonë të të ecë fati!

I zhytur në këto mendime, Fjodoroviçi nuk e ndjeu se fare pranë tij po kalonte një «Fiat» i zi, duke ecur ngadalë. Vetëm kur u dëgjua boria kumbuese, e veturës, ai sikur u zgjua nga gjumi dhe bëri mënjanë i trembur e me zemër të ngrirë. Pastaj, i frikësuar, vuri re se «Fiati» i zi qëndroi dhe se dikush ia bëri me dorë që t'i afrohej. Fjodoroviçi preku vendin ku mbante rublat dhe tërë frikë iu afrua veturës. Mbi timon qëndronte një goxha burrë i qeshur, i cili dashur pa dashur i imponoi një farë respekti Fjodoroviçit.

— Ku do të shkoni? — iu drejtua gjithë përzemërsi burri mbi timon.

— Në Moskë — ia ktheu i drojtur Fjodoroviçi.

Burri mbi timon, pa i kthyer asnjë fjalë, hapi derën e «Fiatit» dhe sakaq Fjodoroviçi e ndjeu veten të fundosur në ndenjëset e buta e të rehatshme. Pastaj «Fiati» fluturoi. Fjodoroviçi preku dhe një herë vendin ku mbante rublat e tij të dashura e pastaj i mbylli sytë nga kënaqësia. Ndjehej i lodhur nga rruga që kishte bërë më këmbë.

«Kësaj i thonë të të ecë fati! — mendoi kushedi për të satën herë. — Rubla plot, moskovit u bëra, me «Fiat» po udhëtoj... Është e bukur jeta...»

Si mbaroi këtë mendim, i hodhi një vështrim mirëbërësit të tij.

— Ju shoh të gëzuar — i tha burri mbi timon.

— Është e bukur jeta! — ia ktheu Fjodoroviçi dhe preku edhe një herë vendin ku mbante rublat. — Shita shtëpinë që kisha në fshat dhe që sot e tutje jam moskovit...

Burri mbi timon nuk tha asnjë fjalë, veçse buzëqeshi dhe tundi kokën. Pastaj, duke mos i hequr sytë nga rruga e gjerë e plot lëvizje, futi dorën në xhep. Fjodoroviçi, të cilit i tërhoqi vëmendjen kjo lëvizje, ngriu i tëri.

«Ai do të nxjerrë tani nga xhepi revolverin ose thikën! — mendoi i lemerisur e i penduar. — Për të tilla raste dëgjojmë thuajse çdo ditë. Ç'pata unë që i tregova se kam shitur shtëpinë!»

Pa u vënë re nga tjetri, zgjati dorën dhe kapi dorezën e derës, i gatshëm të hidhej menjëherë nga «Fiati», kur fytyra e tmerruar iu shkruftua dhe i buzëqeshi. Pa se burri mbi timon nxori nga xhepi i xhaketës paketën e cigareve.

«Budalla! — shau veten Fjodoroviçi. — Ke ca rubla të kimbura në xhep dhe po të hyn lemeria! Budalla!» përsëriti,

Burri mbi timon nxori një cigare nga paketa dhe gjithë dashamirësi ia zgjati atij. Pastaj mori edhe një për vete dhe e futi përsëri në xhep.

«Je fare leshko dhe i pasjellshëm! Po e tregon veten kokë e këmbë se je një muzhik e shkuar muzhikut! — shau përsëri veten Fjodoroviçi. — Burri i botës të bën nder duke të marrë në veturën e tij, ndërsa ti nuk kujtohesh t'i japësh një cigare! Së paku nxirr shkrepsen dhe ndizja, o torollak!» e, duke sharë veten kështu, nxori shkrepsen, ia ndezi atij, pastaj të vetën.

«Fiati» i zi vazhdonte të ecte me shpejtësi. Kur cigarja i vajti në gjysmë Fjodoroviçi ndjeu se filluan t'i rëndohen qepallat. Po i vinte gjumë. U mundua ta dëbonte, por s'ishte punë. Nxori kokën në dritare, që t'ia rrihte era, preku mekanikisht vendin ku mbante rublat dhe menjëherë koka iu var e s'lëvizi më. Burri mbi timon, i cili përgjonte nga pasqyra që kishte përpara, buzëqeshi dhe frenoi buzë rrugës. Cigarja e kishte bërë efektin plotësisht, bile më parë nga sa kishte shpresuar...

* * *

... Kur i doli gjumi, Fjodoroviçi e pa veten të shtrirë poshtë rrugës, në të hyrë të Moskës. Brofi më këmbë i tmerruar. Gjëja e parë që i vajti në mendje ishte xhepi i fryrë. Zgjati dorën por ndjeu se ai ishte «shfryrë». Pastaj e fundosi dorën në xhepin e brendshëm të xhakëtës... asgjë! Portofoli, me tërë atë shumë rublash, ishte zhdukur pa lënë gjurmë! Kontrollloi të gjithë xhepat me radhë, përsëri asgjë! Ndjeu se iu njomën sytë. Si në vizion i kaluan «Fiati» i zi, burri mbi timon, cigarja që i kishte dhënë ai dhe pastaj... asgjë. Nuk i kujtohej asgjë tjetër? Nga tërë ato rubla, xhepat i kishin mbetur trokë!

«Më ka grabitur maskarai! Policia, vetëm ajo më ndihmon! — tha me vete dhe, si i marrë vrapoi drejt qytetit zhurmëmadh, qytetar i të cilit ishte bërë pikërisht atë ditë...

* * *

U fut me rrëmbim në rajonin e milicisë dhe qëndroi para oficerit të rojes.

— Tavarish oficer!... Më grabitën... Më rrenuan!... Rublat e mia të dashura!... Shtëpinë time... Në mes të ditës... me cigare... Burri mbi timon... «Fiati» i zi...


Ushtaraku, që matanë vitrinës së xhamtë, e vështronte duke mos kuptuar asgjë nga këto fjalë të ngatërruara. Nuk po merrte vesh nëse bëhej fjalë për një grabitje rublash, shtëpie, «Fiati» apo të të gjitha këtyre bashkë.

— Mos u shqetësoni, qytetar! — i tha pastaj duke u munduar të buzëqeshë. — Do ta gjejmë grabitësin.

Ejani nesër, pasi shefi i seksionit të kriminalistikës është me shërbim!

Ai tha këto fjalë dhe përplasi me forcë sportelin e xhamtë, i cili për pak i copëtoi hundën Fjodoroviçit.

Me lotët që mezi po i mbante, Fjodoroviçi filloi të zbresë shkallët e rajonit të milicisë, kur sa nuk u përplas me dikë. Ngriti kokën dhe u ndodh ballë për ballë me një burrë. Ai i kërkoi ndjesë gjithë për-



zemërsi, i buzëqeshi dhe vazhdoi t'u ngjitej shkallëve. Fjodoroviçi, disi i hutuar, u kthye dhe e vështroi tjetrin tek po largohej.

«Është tamam ai! — mendoi. — Burri mbi timon... Grabitësi im!»

U kthye dhe vrapoi drejt tij. Ai kishte qëndruar tek oficeri dezurn dhe se ç'po bisedonte me të. Pastaj u kthye, e vështroi buzagas Fjodoroviçin, i tundi kokën dhe u largua.

— Tavarish oficer! — iu drejtua Fjodoroviçi oficerit dezurn. — Ky është ai... burri mbi timon... Ky më grabiti...

— Ç'thua ashtu, more? — u dëgjua zëri kërcënues i oficerit dezurn. — Ky është tavarish Aleksejevi, — shef i seksionit të kriminalistikës!

— Ky është, ky! — thirri fort Fjodoroviçi. — E njoh mirë! Ky më dha cigare... Rublat! Rublat e mia të dashura!...

— Kolja! Grisha! — u thirri oficeri dy milicëve që atë çast po kalonin aty pranë. — Merrni këtë qytetar dhe mbylleni në birucë! Me sa duket është i çmendur dhe paraqet rrezikshmëri shoqërore!

Fjodoroviçi desh të thoshte diçka, por ndërkohë dy palë duar të fuqishme e mbërthyen dhe filluan ta tërhiqnin zvarrë...

G J U R M A...

Milici Shtallnikov ishte në krye të detyrës. Kishte zënë vend në udhëkryqin më të dalë të qytetit dhe me një vështrim prej indiferenti ndiqte automjetet e ndryshme që i kalonin para syve. Ishte i mërzhitur. Dhe mërzhinë nuk ia sillte koha e vrenjtur e me shi, që po mbante prej ditësh, por shefi, koloneli Prokofiev. Shtallnikovit ende i gjëmonin në veshë fjalët e tij të ashpra. Dhe përse? Vetëm e vetëm sepse Shtallnikovi, një natë, gjatë shërbimit, nuk kishte mundur të bënte zap një grup të rinjsh, të cilët kishin përdhunuar, në një nga parqet e qytetit, vajzën e tavarish Aleksejevit, figurë e ndritur e qytetit të tyre. Po pse, mos e kishte lënë mendja milicin Shtallnikov që t'u afrohej atyre të rinjve të tmerrshëm? Apo nuk ishte i freskët rasti i Sandrovit, kolegut të tij, të cilit një grup të rinjsh ia kishte bërë kurrizin më të butë se barkun?

Si eci gjer në një farë vendi, Shtallnikovi qëndroi dhe nxori paketën e cigareve nga xhepi. U bë gati të nxirrte një cigare, por s'qe e thënë. Një makinë, duke ecur si e çmendur, i ra mes për mes një pellgu gjithë llucë dhe bëri tutje. Shtallnikovi ndjeu se buzët iu ngjitën, si t'ia kishte dyllatur ndonjë dorë e padukshme. I hodhi një sy uniformës dhe pa se ajo ishte llangosur fund e krye nga balta që kishte shpërndarë ajo makinë e mallëkuar. I nervozuar, fla-

ku tej paketën e cigareve, (e lyer gjithë baltë edhe ajo) dhe fshiu fytyrën me mëngën e xhaketës. Pastaj nxori bilbilin dhe i fryu me tërë forcën e mushkërive. Makina, si të ishte ndodhur para ndonjë gremine, frenoi duke fishkëllyer. Nga kabina nxori kokën shoferi. Pa lëvizur nga vendi, me fytyrën sterrë, milici Shtallnikov i fryu edhe një herë bilbilit dhe i bëri shenjë të afronte makinën.

— Ç'më ecën kështu si i dehur, more? — iu çorr milici Shtallnikov shoferit që iu afrua dhe, duke mos ditur ç't'i thoshte tjetër, i hodhi një sy karrocërisë së makinës e shtoi: — Dokumentin e ngarkesës!

Shoferi u dha një të shtyrë me kokë flokëve që i kishin zënë fytyrën, buzëqeshi si i zënë në faj dhe, pa thënë asnjë fjalë, mblodhi supet.

— Si?! Nuk ke dokument për materialin që transporton? — e ngriti edhe më zërin Shtallnikovi.
— Çfarë ke ngarkuar?

— Njëzet arka me parket dhe pllaka mermeri!
— ia ktheu qetë shoferi. — Unë s'bëj tjetër veçse zbatoj urdhrat e eprorëve. Urdhëroni e bisedoni me magazinierin Panfiroviç, i cili shoqëron mallin!

Si tha këto fjalë, shoferi iu afrua makinës, hapi derën e kabinës dhe se ç'i tha dikujt që ishte brenda. Milici Shtallnikov vuri re se nga kabina dolën në fillim dy këmbë të shkurtra e të trasha dhe pastaj një trup i majmur e i rrumbullakosur, i cili filloi të rrokullisej drejt tij.

— Para jush, magazinieri Panfiroviç! — u paraqit si ndonjë ushtarak ai. — Si qëndron puna, tavarish milic?

— Ç'është ky automjet i ngarkuar, pa asnjë dokument? — i tha shkurt Shtallnikov.

— Dëgjoni, tavarish milic. . . E dini si është puna?

— filloi të përtypet bullafiqi Panfiroviç. — Mua më urdhëruan, dhe. . .

— Kush të urdhëroi? — e ndërpreu Shtallnikovi.

— Direktori Emeljanov!

— Më shpjer menjëherë tek ai!

— Ai sot në mëngjes u nis për diku me shërbim, tavarish milic! — ia ktheu Panfiroviçi.

Milici Shtallnikov filloi të mendohet. «Me sa duket, pa dashur, u vura në gjurmët e një bande hajdutësh! — mendoj. — Thua ta ndjek më tej, apo? . . . «I doli para syve trupi i bërë petë i kolegut Sandrov dhe i kaluan drithërima nëpër trup. Pastaj i doli para fytyra e ashpër e kolonelit Prokofjev. Po të zbulonte një grup të tillë, koloneli patjetër që do ta falenderonte e do ta shpërblente. . . Bile s'ishte çudi që me këtë rast ti jepte edhe ndonjë gradë. . .

I joshur nga mendimi i fundit, Shtallnikovi u ngrëhos, preku me marifet tytën e revolverit që mbante nën xhaketë e pastaj iu drejtua Panfiroviçit:

— Ku do t'i shpini këtë parket e këto pllaka?

— Në të dalë të qytetit, buzë pyllit me mështekna, për. . .

— Nisu menjëherë për atje! — urdhëroi shoferin Shtallnikovi dhe, bashkë me ata të dy, zuri vend në kabinën e makinës.

Tani ishte i bindur se në këtë mes kishte të bënte me një vjedhje të pasurisë së shtetit. Dhe pjestar i këtij grupi ishte pa dyshim edhe ky shofer, që i kishte llangosur uniformën edhe ky Panfiroviç i rrumbullakosur edhe. . . Po, po, kishte të bënte me një grup të tërë! Pastaj i doli para syve përsëri fytyra e qeshur e kolonelit Prokofjev, falënderimi i tij para gjithë milicëve të rajonit, një palë spaleta. . .

Nga gjithë këto mendime e ndërpreu frenimi i menjëhershëm i makinës, që kishte qëndruar para një vile që ishte në përfundim e sipër.

— Këtu? — e pyeti trashalugji?

Panfiroviçi pohoi me kokë. Shtallnikovi u hodh nga makina preku edhe një herë revolverin nën xhakëtë dhe sakaq u ndodh në verandën e vilës. Që andej dalloj se në sallon po bisedonin dy njerëz. Zërat e tyre arrinin gjer tek ai. Shtallnikovi bëri edhe dy hapa dhe ngriu në vend. Në njërin nga burrat, që i kishin kthyer kurrizin, dalloj shpatullat e gjera dhe zërin e ngjirur të kolonelit Prokafjev!

— Tani s'presim tjetër, veç parketin dhe pllakat dhe vilën e keñi gati, tavarish kolonel — i tha bashkëbiseduesi.

— Ato do të vijnë sot! — ia ktheu koloneli Prokofjev — Dhe shpejtoni pak. Sonjës sime nuk i pritet sa të vijë e të shijojë bukurinë e kësaj vile e të këtij vendi të mahnitshëm!

Si tha këto fjalë, ai u kthye e filloi të ecë. Kur doli në verandë, ndeshi në vështrimin e milicit Shtallnikov, që kishte mbetur si i budallallepsur.

— Ç'ka ndodhur, Shtallnikov? — iu drejtua me rreptësi.

Shtallnikovi puliti disa herë qepallat, pastaj fërkoj sytë, si të kishte qenë në ndonjë ëndërr, mori drejtqëndrim dhe, si ndonjë aktor i shkëlqyer improvizues, raportoi pa iu dredhur zëri:

— Tavarish kolonel! Sollëm parketin dhe pllakat e vilës suaj! U mora vetë me shoqërimin e makinës, pasi, siç e dini, po kalojmë ditë të vështira, dhe. . .

— Mirë, Shtallnikov! — i buzëqeshi koloneli. — Vetëveprimi yt më pëlqen. Dhe tani merru pak me shkarkimin e makinës!



Koloneli Prokofjev tha këto fjalë dhe u largua bashkë me burrin tjetër.

Milici Shtallnikov, duke u lëkundur si ndonjë i dehur, u drejtua nga makina. Iu afrua asaj dhe nën vështrimet tallëse të shoferit dhe të bullafiqit Panfiroviç, uli anët e makinës dhe vuri mbi kurriz arkën e parë të mbushur me parket. . .



PËRMBAJTJA

1. Me qeleshe, feste dhe kasketë...	3
2. «Ceremonia e hapjes...»	8
3. «Kursimet e Kasemit	14
4. Ku janë brigadierët?	19
5. Thesi	24
6. Mësalla me dy faqe	30
7. Zhdëmtimi	35
8. Goditje në sheqë	41
9. Komshiu që hapte vrima	46
10. Dy net pa gjumë	52
11. Fasulet e Maqos	60
12. Zinxhiri	79
13. Burri mbi timon	86
14. Gjurma...	92